

INTERVISTË ME BAJRAM ZYMBERIN

Gjilan | Data: 2 qershor, 2023

Kohëzgjatja: 164 minuta

Të pranishëm:

- Bajram Zymeri (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)
- Malisa Zymeri (E pranishme)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Bajram, nëse mundeni me u prezantu, ni biografi të shkurtë edhe me tregu diçka për familjen e juaj, prejardhjen.

Bajram Zymeri: Pra, une quhem Bajram Zymeri, jom fëmija ma i vogël i prindëve Ali dhe Fatime Zymeri. Në Gjilan jemi prej vitit 1912-ën, domethonë baba im dikun gjashtë vjeçar ka ardhë në Gjilan. Gjyshi im Zymeri ka qenë mjeshtër i drunit, thojshin se u konë mjeshtër i mirë i lugjëve të mullinit. Kështu që, baba im ka fillue me marrë atë zanat, domethanë zdrukhtarinë. Ka qenë mjeshtër, një ndër mjeshtret e parë në Gjilan si zdrukhtar me Osman Brestovcin, ai ka qenë i pari në Gjilan, e baba im me to ka punue edhe e ka perfeksionue shumë këtë zanat. E ka deshtë me shpirtë drunit, saqë ka marue dry, dritare, shifunjera ju kanë thonë në atë kohë, tash mobile po i thojnë. Ka marue sandakë për çeziz të nuseve, ka maru dyzenkuti me katror të drunit, saqë kish pasë maru ni dyzenkuti që s'ka ditë kërkush me e çelë, veç ai që e ka ditë. E thojke që ja kanë marrë e ja kanë çu në Beograd.

Anita Susuri: Çka osht' ajo?

Bajram Zymeri: Dyzenkuti osht' ni kuti dikun 40 me 30 [centimetra] për nuse {përshkruan me duar formën e kutisë}. Ku e kanë majtë... jo tash kozmetikë po i thojnë, tash ato të nusës, ato arin, ato ni kuti, çantë e nusës. Eh, po ja u tregoj ni rast i kishin, '44-tën, i kanë vra dikun ngat katër mijë në Gjilan shqiptarë, i kanë marrë i kanë shti në burg edhe mo s'kanë dalë hiç, gjyshin tem, babën e nonës, pesë ditë e kanë majtë, kur e kanë lëshu të nesrit ka vdekë prej torturave. Edhe ni ditë e thirrin edhe babën, menon a me shku a mos me shkue, po thotë, "S'i kom bo kërkujtë kurgjo", edhe vendosë me shku.

Kur shkon, OZNA¹ i kanë thonë asaj policisë të asaj kohe, edhe e çojnë te ai kryeshefi, po thotë, ai kryeshefi e sheh thotë, "A je ti Ali Zymeri?" Thotë, "Ali Dyngjeri", se dyngjeri i kanë thonë zdrukhtarëve, edhe p'i thotë, "Më kanë folë se ti munësh me ma kry ni punë". Edhe e nxerrë ni pushkë

¹ Drejtoria e Mbrojtjes Popullore, akronimi OZNA (serb. *Odsjek za Zaštitu Naroda*) shërbim informativ i Jugosllavisë, i themeluar më 13 maj 1944, nën udhëheqjen e Aleksandar Rankoviçit, antarit të lartë të Politbirosë politike dhe bashkëpuntorit të afërt të Josip Broz Titos.

automatike e cila e kish pasë të thymë kondakin. Kondak osht' ajo pjesa në krahun e pushkës {përshkruan me duar te krahu}, "E kom trofe të luftës", baba vet me veti thotë, "A për qita më paski thirrë a?" Se u frigu mos p'ë torturojnë, p'ë mbysin.

E merr baba edhe ja maron me dru të arrës, saqë kur ja ka çue ai s'ka besu që, a osht' e mundun, edhe i ka thonë, "Sa vjet ke punu në fabrikë të pushkës?" Baba thotë, "S'kom punu kurrë". E thotë, "Ballistave sa pushkë ja u ke ndreqë?" Se në atë kohë kanë qenë, "Vallahi", thotë baba, "nuk i kom ditë a jonë ballista, a partizanë, po une e kom zanat", thotë, "kush t'më ka prue me i ndreqë, i kom ndreqë", thotë, "mu s'më ka interesu", thotë, "a o ballist, a partizan".

Na kemi qenë tre vllazni, vëllau i madh Sabiti si 16 vjeçar ka punu si mësues me ni fshat, për herë të parë e ka filluar në atë fshat për herë të parë ka filluar shkolla. Harrova me cekë për babën, diku në '38-ën, 1938-ën, me gjyshin e një Besim Ahmetit ka qenë teknik i kimisë, prej Prizrenit i ka prue ni thes abetare në Gjilan. Në atë kohë ka qenë rrezik shumë i madh, baba jem i ka kry katër klasë për m'u bo mësues, mirëpo nuk ka pranu m'u bo mësues, se tha, "Ndoshta nuk di une me fëmi me punue", se edhe shumë hoxhallarë e kanë kry qatë shkollë e thojke, "Hoxhallartë me naj mejtep² kanë punu me fëmi [e kanë] ma kollaj. Une e di zanatin e drunit", edhe nuk ka shkue si mësues.

A ni Mulla Tefiki e kom pasë mësues të parë, une për shembull, që e ka kry qatë shkollë. Edhe vëllau si e ka krye shkollën e mesme e kanë caktue mësues me ni fshat, dikun osht' tash në kufi me Sërbinë, Muqibaba. "Aty", tha, "s'kishte as drrasë të zezë as kurgjo. E kom marrë", tha, "derën edhe e kom marrë qymyrin e kom tretë {përshkruan me duar me lëvizje rrethore} edhe e kom ly derën e kom bo të zezë", edhe në derë të dhomës ka shkruie me shumës. Pastaj osht' bo, ka shku në tri fshatra, atëhere i kanë transferue qysh kanë mujtë në tri fshatra të Gjilanit, edhe në fund ka shku nihere si sekretar i postës ka punu, edhe e kanë çu në Teknikën Popullore, u formu Teknika Popullore.

Teknika Popullore ka qenë si ni... tash ni organizatë joqeveritare e cila u marrë me edukimin teknik të rijëve. Ai ka qenë radio operatori i parë në Kosovë, vëllau, ka qenë edhe kryetar i Lidhjes Radioamatore të Kosovës, ka qenë edhe kryetar i Lidhjes së Radioamatorës së Jugosllavisë ni kohë. Ka punue në aktivitete të ndryshme, bile mas çlirimit tash të Kosovës, Lidhjen Radioamatore të Kosovës osht' e para organizatë në Kosovë që u pranu publikisht mbarë botënore, ata vëllau e ka, me punë të madhe se ka pasë shumë... në Jugosllavi të atëherit, radioamatora që kanë bashkëpunue, e shumë përkrahje të madhe i ka dhonën Kroacia.

A Sërbia osht' munue edhe e para e ka marrë prefiksin ZA [Teknika Popullore], edhe deri në vdekje ka qenë kryetar nderi i Lidhjes Radioamatore të Kosovës, para pesë vite ka vdekë. Une si fëmi,

² *Mejtep, Maktab* (përkthimet arabe përfshijnë makteb, mekteb, mektep, meqteb, meqtab), i quajtur gjithashtu një Kuttab ose shkollë, është një shkollë fillore. Megjithëse u përdor kryesisht për të mësuar fëmijët se si të lexojnë, shkruajnë, gramatikë dhe studime Islame si Kira'at (recitim Kur'anor), lëndë të tjera praktike dhe teorike gjithashtu shpesh mësoheshin.

domethonë fillet e edukimit teknik i kom marrë në Teknikën Popullore, sepse vëllau i dytë Shefqeti në vitin '61 ra në burg politikisht dhe u dënu tri vjet.

Anita Susuri: A ka qenë në lëvizje?

Bajram Zymeri: Në lëvizje ka qenë ilegale, në kohën e Adem Demaçit edhe Kadri Halimit ka qenë në burg. Bile na gjashtë muj nuk e kemi ditë a osht' gjallë, a osht' i vdekun, a... kurrëfarë.... Në Prizren ka qenë i burgosun, se ni herë në Beograd sa ka qenë student e kanë burgosë dy javë ditë. Tanaj iki prej Beogradit shkoi në një fshat në Brodosanë të Prizrenit, [aty] hini mësus. Edhe aty me një shok të tijnë të Bajës të Pejës, Ilaz Bica osht' burgosë, '61-shin u burgosë. Edhe vëllau u dënu tri vjet, Ilaz Bica dy vjet, bile kanë deshtë me ikë kur e kanë diktur që p'i njëkin. Kanë menu që me dalë në Shqipëri, edhe kur kanë menu që kanë dalë në Shqipëri e kanë taku ni çoban të stanit, thotë, "Ku jena?" "Oh", thotë, "ju jeni thellë në Shqipëri, a jeni untë o djem?" Edhe të untë jonë kanë sigurisht edhe ju ka dhonë djathë, e bukë e, ato e ato. A në tjetrën anë, u shku i ka lajmëru.

"Në çfarë mënyre?" Vëllau thotë, "Nuk muj me marrë me mend qysh, veç kur na ka rretheku policia na kanë marrë edhe na kanë dërgu në burg". Na gjashtë muj s'e kemi ditë a osht' gjallë, a osht' i vdekun, a ku osht', a çka osht' a. Na ka pasë shkru që, "Do të iki në Shqipni se këtu s'kom mo ven". Edhe ni ditë prej ditësh një polic kish qenë aty në Prizren në shërbim, i Komunës të Gjilanit, edhe kur ja çon shoqja burrit bukën për darkë, e sheh vëllaun tu e shëtitë prej ni dhomë në dhomën tjetër. Edhe i thotë burrit të vet i thotë, "More", thotë, "qiky Shefqeti i axhës Ali, ata kërkush s'po dijnë a osht' gjallë a osht' vdekë".

Anita Susuri: Ajo ju ka njoftu?

Bajram Zymeri: Ajo na ka njoftu se ka qenë kojshike e jona, masi e ka krye detyrën ai polici dikun ka ora 1:00 të natës, e ka marrë motorin, e kishte pasë një motor, në dimën {ngritë gishtin tregues} ka ardhë në Gjilan edhe na ka njoftue që, "Shefqeti o në burg në Prizren". Edhe thotë, babës tim i thotë, "Me shkue te kryeshefi i policisë edhe me kërkue me pa djalin, nëse të thojnë, 'Jo', ti mos dil prej zyrës". Ashtu baba vepron edhe ja qesin vetëm ni minut, vetëm ni minut e ka pa baba, mirëpo mjaftushëm që osht' gjallë edhe asgja tjetër. Edhe një rast për vëllaun, '68-tën, se mas... si dul prej burgit hini mësus, ishte në fshatin Malishevë dikun ka ora... me 27 nëntor erdh edhe p'i thotë babës, "Me ma maru ni shtizë për flamur". Baba ja maron dikun në ora 5:30 në mbramje, se dimën ishte nëntori, ishte terr, e kemi vnue flamurin në tranin e shpijës te dera e hymjës. Në tavan e kemi marrë, une isha 20 vjeçar në atë kohë, 18 vjeçar, në '68. Qebe, do shilte, që me rujtë, se osht' ni fshat i sërbeve këtu afër, e u frigojshmi mos po naj prekin. Po ju tregoj që kemi pasë edhe armatim, e patëm vendosë na me nëse...

Anita Susuri: Ka qenë gjatë demonstratës?

Bajram Zymeri: Jo, në '68-tën, me 27 nëntor, për ditën e flamurit u përgaditshim na. Edhe e kemi vnue për herë të parë në Gjilan flamurin me ni shpi është vendosë në shpijën tonë, me 27 nëntor, '68. Dikun ka ora 1:00 të natës, në atë kohë u organizojke Partia Komuniste kujdestari nëpër rrugë mos po bojnë naj ekces. Edhe kur erdhën te shpija jonë thanë, “U Shefqeti e paska qitë flamurin” {ngritë gishtin tregues}. Edhe kthehën në Komitet me lajmëru që... mirëpo, nuk bonën aty kurgjo. Na pritëm, nuk ndodhi kurgjo {tundë kokën në shenjë mohimi}. Rexhep Hajrullahu ka qenë në atë kohë Sekretar Komiteti, ni qytetar i cili na ka njoftë mirë, “Ah”, thotë, “ai magar e paska qitë”, a din. Thotë, “Hajde hiqju tina”, s'don me bo të madhe. E domethonë për herë të parë [në Gjilan], unë për Kosovë nuk e di, për 28 nëntor ka valu flamuri në shpinë tonë. Bile me rastin e vdekjes të vëllaut, kryetari i Republikës së Shqipërisë ka qenë kryeshnosh, na i ka dhuru flamurin {bën sikur dhuron flamurin} (fillon të qajë) osht' emotive.

Anita Susuri: A don me pushu?

Bajram Zymeri: Po.

[Këtu ndërprehet video-intervista]

Anita Susuri: Zoti Bajram, po du pak me ju pytë te fëmijëria e ju në kujtimet çka keni, qysh ka qenë jeta dhe familjet në Gjilan edhe në shkollë, jeta kulturore?

Bajram Zymeri: Na kemi qenë ni familje e nderume këtu në qytet, se domethonë jonë konë qytetarë të vjetër edhe kem pasë respekt të madh për qytetartë, kushdo që na ka lypë për shembull neve veç, “Ali Dyngjeri”, ose, “Shefqeti, Sabiti”, s'ka pasë problem se na ka njoftë çdokush. Kështu që, kemi pasë respekt të madh. Unë si fëmi... kemi qenë edhe familje e lumtun, kemi qenë ni familje shumë e lumtur, se harrova me tregu i kemi edhe dy motra, bile jonë gjallë motrat njona osht' 85 vjeçare, njona osht' 79 vjeçare, edhe unë jom fëmija, thashë, ma i vogli, tash 73 vjeçar jom. E kemi qenë ni familje shumë e lumtun edhe përparimtare me thonë, i kemi pasë ato ndjenjat përparimtare.

E si fëmijë tregova, unë jom aktivizu në Teknikën Popullore te vëllau, sepse ishte mundësija për një edukatë teknike me pasë edhe kemi pasë mundësi tanaj edhe me zgjeru rrethin e të rijëve për me u aktivizu aty. Kemi pasë shoqni jashtëzakonisht të madhe, të mirë, të shnoshë, në atë kohë. E aty bazat i kom marrën, domethonë unë si fëmi kom fillu me u rritë në Teknikën Popullore. Aktiviteti, në atë kohë jonë organizu jo basketboll, e jo karnivalle, jo... bile ni here u patë organizue në qendër të qytetit para hotelit “Kristal”, me lujtë shah me ni lojtar të Gjilanit edhe të Prishtinës, e patëm organizu nëpërmjet radiolidhjes.

E patëm maru atë tabelën e madhe edhe çdo potez që u lujke personi i Prishtinës edhe ky i Gjilanit, edhe ishte me altoparlanta u ndëgjojsin, njerëzit u mbledhshin. Në atë kohë s'ka pasë komunikacion si këtu tash, domethonë para hotelit, u mledhke u bojke një guzhvë e madhe. Edhe ju interesojke se

edhe nishin për shembull kur e folke ai potezën prej Prishtinës, edhe sidomos Teknika Popullore i ka organizu qato farë ceremonitë qysh me thonë të qytetit. Verës sidomos verës u organizoshin ose kah maji, për shembull atëhere ka qenë Dita e Rinisë³ e ashtu, a din. Ka qenë aktive Gjilani shumë, në atë... qysh me thonë në kulturorën, ato lamitë.

Anita Susuri: Po ato karnivalet që i përmendet, çka ju kujtohet?

Bajram Zymeri: Po krejt Organizatat Punuse, Lidhja e Rinisë në atë kohë ka qenë, Teknika Popullore, krejt qytetartë u angazhojshin, bojshin turli veshje, turli... kerr me dru për shembull, qeze [qerre e mbuluar], edhe prej stacionit të autobusave tash që osht' atje te spitali, e shkojshin deri në anën e kundërt të qytetit, ishte nifarë parakalimi me thonën, s'ka pasë tjetër sen po veç ni parakalim bojke, me pa turli veshje, turli, u bojke shumë interesant. Për atë kohë po foli, se ndoshta tash s'i bjen në sy kërkujna ajo, por për atë kohë ka qenë interesant.

Anita Susuri: Ka qenë naj ditë e veçantë?

Bajram Zymeri: Jo, s'ka qenë ni ditë e veçantë, ma tepër për shembull në maj domethonë Lidhja e Rinisë kur i organizojke do ceremoni do farë asi, e përndryshe...

Anita Susuri: Edhe për këto takimet e majit.

Bajram Zymeri: Jonë majtë "Takimet e Majit", po vijshin ansamble të ndryshme zgjatke. Tash e kanë bo "Flaka e Janarit" në Gjilan, kjo osht' rrjedhojë e qatyne "Takimeve të Majit", domethonë tash u bo "Flaka e Janarit". Tash ka, edhe teatri lunë, atëhere vetëm ansamblet muzikore marrshin pjesë. E ka pasë ni aktivitet në përgjithësi në qytet në atë kohë.

Anita Susuri: E në këto "Takimet e Majit", a jonë bo disa ditë apo kanë qenë...

Bajram Zymeri: Disa ditë, tri ditë kanë qenë, sa më kujtohet tri ditë ka qenë.

Anita Susuri: Ka pasë nonstop ngjarje kulturore?

Bajram Zymeri: Po ngjarje, kështu në Teatrin e Qytetit, domethonë Shtëpia e Kulturës i kanë thonë. Pastaj kur u boe teatri gjysmë profesional, atëhere u thirrë Teatri i Qytetit, por çdo gja aty në ndërtesën e Teatrit të Qytetit jonë bo manifestimet.

Anita Susuri: A ju kujtohet këto karnevalet në cilin vit jonë zhvillu, kur jonë ndërpre?

³ Çdo vit, më 25 maj, mbaheshin sletet në qytete të ndryshme të Jugosllavisë për të shënuar Ditën e Rinisë dhe ditëlindjen e liderit të atëhershëm Josip Broz Tito. Sleti ishte një manifestim sportiv vjetor, që përfshinte sportistë, nxënës, studentë, punëtorë dhe ushtarë të dalluar.

Bajram Zymberi: Valla dikun... deri dikun '76-'77 kanë zgjatë ato, jonë konën edhe... në Gjilan jonë mbajtë panagjyret, nuk e di a e dini, dy herë në vit. Njo ka qenën me 7 korrik ose me gusht, ajo s'ka ndërru kurrë, a njo ni panagjyr ma herët, ajo ka ndërrue. Tash qysh i kanë pasë nuk më kujtohet, ato datat qysh i kanë caktu. Veç, panagjyr, "Dita e Panagjyrit" i kanë thonë edhe ajo ka zgjatë tri ditë. Komplet qendra e qytetit ka qenë me... se u bo shitje domethonë, vishin prej kahmosit, prej kahmosit vishin, edhe ishte panagjyri ni pazar...

Anita Susuri: Si panair.

Bajram Zymberi: Si panair, me ato teshat, krejt tesha ka qenë për shembull qyteti. Bile i kanë pasë ndërru dy here venin, ni herë ka qenë pej stacionit deri te xhamija, herën tjetër, mas disa vjete e patën ndryshue e qitën në këtë rrugën që shkon për Prishtinë, edhe nihere mas stacionit të autobusave e kanë pasë bo. Tri vena i kanë ndërru lokacionet për shumë vjet, bile tash m'u kujtu ni ngjarje interesante, se vishin prej Pejës, prej Prizrenit, kahmosit vishin, qylyma bishin prej... sidomos prej Pejës. Eh, m'u kujtu ni ngjarje interesante, ka qenë baba i ni luftarit, në realitet ni mësusit të cilin ka qenë ni atëdhetar. Sigurisht ka qenë edhe aktivisti i organizatës të msheftë, asi, në Konçul që osht' në kufi kha, Konçuli, bile ka metë në Sërbi, Konçuli. Aty pabesisht e kanë vra ni mësus të Pejës, e kanë tradhëtu, e kanë çu me ni shtëpi edhe e kanë vra. Baba i atij mësusit, për çdo vjet ka shkue me vizitu vorrin e djalit të vet, mirëpo kurrë as ujë s'ka pi në atë fshat.

E tash, na e kemi pasë ni dhandërr në atë fshat, e nuk e dimë na se si ka ardhë në kontakt me atë babën e atij dëshmorit, muj me thonë *serbez* [Tur.: lirshëm] edhe se ai vinte edhe shitke qylyma në panagjyr në Gilan. E tash i ka tregu për familjen tonë që jemi patriotike edhe ai sa here ka ardhën, ka ardhë te na ka bujtë, se nuk ka zonë besë në kit anë knejna, se ja kanë vra djalin në besë. Të vetmen shpi që ka pasë besë, që ka besue, ka qenë shpija jonë. Mixha Salih ka qenë i Pejës, ka shitën qylyma ka shitë ai. Më kujtohet, nuk e kisha nanën këtu, motra jem ishte e re atëhere, ajo kish maru ni pogaçe, ai u mahnit a din edhe i thojke, "Mos të paftë syni i keq, mos të paftë syni i keq", një gja shumë interesante dhe ashtu.

Anita Susuri: E ju qysh e kujtoni si fëmi, si ma i ri, vendin ku keni jetu, rrugën, qytetin, Gilanin, se u konë '57-ta...

Bajram Zymberi: Në '50-tën thashë kam lindun, gjashtë-shtatë vjeçar, domethonë tash ku jemi këtu ka qenë shtëpija jonë. Kom pasë shumë të gjeneratës time shokë, kom pasë djalin e axhës mo, kemi qenë me ni oborr, i kemi pasë edhe shoktë tjerë këtu. Kemi lujtë, atëhere i thojshin kličkakuti, pilifunca, jonë konë do shtaga të holla {përshkruan me duar shtagat} se pluhni të mytke në rrugë, e i gjujshmi shtagat {bën sikur hedhë shtagat} kush po i gjunë ma larg. E u bojshmi krejt pluhun aty, po osht' interesant se na edhe në Gjilan ka ekzistiu bazeni i qytetit, ka qenë bazeni i parë dikun '58-tën sigurisht osht' marue. Une aty kom fillu domethonë dikun dhetë-njimbdhetë vjeçar jom mësu me

notue, në atë bazen. Tanaj e marunë bazenin olimpik, se qitu afër osht', i kanë thonë baja. Aty ka buru uji, bile gratë e mahallës i kanë la teshat aty. Më kujtohet kanë qenë do gurë të mëdhaj, perajka, nuk e di a e dini se çka osht' perajka, qe qishtu {përshkruan me duar në formë katrori} gati sikur këto që i përdormi tash për mish, e për...

Anita Susuri: Dërrasa.

Bajram Zymeri: Eh dërrasa për m'i la teshat {përshkruan lëvizjen poshtë dhe lartë të larjes së teshave} me sapun i lajshin. Na shkojshmi fëmija u lajshmi qaty, deri sa s'u maru masanej bazeni. E masanej dikun në '60-ën e shpunë aty venin, qitu osht' afër kjo, shpunë fell edhe i marunë gjashtë bazena. Dhetë metra me dhetë metra kanë qenë në ren, te të gjashtit kanë qenë të lidhtë ka ni metër të çelun edhe thojshin se, "Gjilani për 50 vjet e ka siguru ujin". Ai nuk zgjati as 15 vjet se u rrit qaq shumë, filloi m'u rritë qyteti sa... mirëpo, osht' ujë shumë i mirë edhe i pishëm. E u maru edhe bazeni aty edhe na verës gati gjithmonë e kalojshmi si fëmi te bazeni u lajshmi, lujshti.

Përndryshe, në fillim kam qenë në shkollë, i kanë thonë atëhere Vukaraxhiq, e pastaj na e marunë shkollën "Musa Zajmi", edhe kom qenë edhe në foshnjore, ka qenë larg te kisha ni ndërtesë por ajo tanaj u kall. E kah vishmi osht' ni ven, ni Qeshme e Balecit i thojnë. E aty ka qenë te poshtë, dimnit na deri vishmi në shpi u bojshmi qull në borë, ty u... i vnojshmi, atëhere s'ka pasë çanta, i kemi pasë ato strajcat {përshkruan me dorë strajcat} me ato farë tojat në krah me i majtën. Edhe gjithë ditën rrrshitshmi na në atë teposhtzën {përshkruan me duar rrugën poshtë} kur vishmi në shpi mosvet. Nonat e tona veç kukatshin, "Qysh jeni bo kështu krejt ujë në borë" e asi....

Anita Susuri: Dashta me pytë edhe për... se e përmendët që baba ka qenë zdrukhtar, e nana a ka bo diçka apo ka qenë amvise?

Bajram Zymeri: Nana ka qenë amvise, por oja⁴ ka marue, oja, mo ajo gjithë ditën {bën sikur është duke punuar punëdore}. Une domethonë, pak e vjetër u konë, une kur kom mrrie [me kujtu] se dikun 50 vjet i ka pasë. E une e maj në men, ajo oja shumë ka maru, për shamija, ato e ka pasë si asi. Mirëpo edhe gati nja 20 vjet ka qenë e smutë prej asmës, kishte probleme shëndetësore, kështu qi edhe s'ka mujtë fort me tjetër sen, nuk u marrë me tjetër sen vetëm me... edhe ka vujtë shumë se e ka pasë veç ni vëlla edhe ai '56-tën ka shku në Turqi, ka vujtë ajo shumë për atë vëlla.

Anita Susuri: Veç vëlla e motër kanë qenë?

Bajram Zymeri: Jo, edhe ni motër e ka pasë këtu. Po, une bile kur u bojshin ato dyjat, ja nisshin me i kajtë hallet, kajshin nërmjet veti, asi, mu më shkojke pak... E kur jom shkue në '70-ën në Turqi, jom fjalosë me dajën, i kom thonën, "Qysh i ke lonë dy motra si kukuvajka me kajtë gjithë ditën, e [për veti] je ardhë ti këtu?" Jom, bash jom fjalosë. Ai edhe s'ka pasë faj se e kanë përndjekë, babën ja mytën të

⁴ Qëndisje në formë lule të cilën e gjejmë kryesisht vetëm në njërën anë në rrobat tradicionale të grave.

tregova që ja burgosën në '44-tën, edhe pastaj ja nisën ktina i lypshin armë edhe... {ngritë supet në shenjë mbarimi}.

Në '44-tën na ka hupë edhe ni mixhë edhe kurrë s'kemi ditën për te kurgjo. Edhe djali i mixhës të babës, ai '44-tën ka ikë me Hysen Terpezën në Greqi, djali i axhës. Edhe ka shku tanaj në Gjermani, na ka çu paketa prej Gjermanisë. '52-tën për herë të fundit naj ka çu ni paketë prej Barit të Italisë edhe në letër na ka shkrujtë që, "Tash e tutje për mue muni me komunikue vetëm nëpërmjet Hysen Terpezës", ja keni ni zanin sigurisht [i drejtohet intervistuesës]. Edhe mo kurrë s'kemi ditë kurgjo për to, na ka çu fotografitë me uniformë angleze. Baba i ka lypë nëpër Kryq të Kuq te dytë, edhe vllavin [e vet] edhe djalin e axhës. Kurrë s'ka mujtë baba deri sa ka vdekë me i gjetën shka ka ndodhë me ta.

Anita Susuri: E ata a kanë qenë ballista apo?

Bajram Zymeri: Djali i axhës [së babës] jo, po mixha jem ka qenë SS në Prishtinë. Edhe baba ka deshtë me nda prej... mos me konë në atë formacion, po me nejtë në shpi. Edhe e ka martue, e ka tërhekë prej atjehit. Veç tri javë ka nejtë me gruen edhe në mbramje ni natë, Mehmet e ka pasë emnin, me nji kojshi tjetër edhe ai ka qenë në SS, veç kanë thonë, "Po shkojmë me u lajmëru në njësi". Edhe kurrë mo prej atij momenti s'kemi ni kurgjo, as për kit Mehmetin tjetër, as për Mehmetin tonë. '88-tën, në "Zërin e Rinisë" ja kemi gjetë emnat e te dy Mehmetave se jonë vra në '44-tën në dhjetor.

Anita Susuri: Ku jonë vra?

Bajram Zymeri: Nuk di kurgjo, ai autor ish konën i Preshevës edhe kish dekë. Ai po get e ka çue në "Zërin e Rinisë" atë libër e asi, të vramë në komunën e Gjilanit, domethanë prej kejt atij numrit aty i kena gjetën edhe emnin e mixhës. Mirëpo, ku o vra, qysh o vra, kurrë s'kemi ditun. Do thojshin, "Tuj ikë për Slloveni u vra në, atje në Mal të Zi", çka s'thojshin turli verzioni, po na nuk kemi ditë kurgjo. Për këtë djalin e axhës të babës gjithashtu s'kemi ditë kurgjo, murrëm vesh që jonë në Turki, Hysen Terpeza, shkumë po nuk e gjetëm, ish kon shku për Amerikë. Ai ka nejtë edhe në Shqipni shumë, bile thojshin, "E ka gjujtë bombën në ambasadën e Ruisë në Tiranë", thojshin ata, "Hysen Terpeza ka gjujtë bombën". Nejse mo... mas çlirimit erdh Hysen Terpeza në Terpezë, e jemi çu na te tretë vllaznitë.

Anita Susuri: Mas çlirimit...

Bajram Zymeri: Të Kosovës tash '99-tën, në 2000-tën veç erdh ai me jetue në Kosovë, Hysen Terpeza. Edhe jemi çu na tretë vllaznitë, e kom marrë qit' kamerën Panasonic {tregon me dorë vendndodhjen e kamerës} edhe jemi shkue në konak të tina. Na priti mirë edhe ja nisëm me bisedue. Edhe e murrëm na fotografinë e Cenit, se Cen e kena thirrë atë djalin e axhës, se Hysen e ka pasë emrin edhe po ja tregojmë. Po i thojmë, "A p'e njeh kit person?" "Uh", tha, "Cen Gilani", me ni ren asihi. Na i tregumë masnej që jemi nipat e Cen Gilanit, u çue, ishte pak i smutë, u çu për s'dyti në kamë na ka marrë në

ngryk Hysen Terpeza. Edhe na i tregumë që letrën e fundit kur e kena marrë na ka thonën Ceni që, “Vetëm nëpërmjet Hysen Terpezës muni me kuptue për mue çdo gja”.

Dikun ni orë e diçka e kom inçizue, e kom inçizimin e Hysen Terpezës. Na tregoi se në ‘52-tën osht’ organizue me e rrëzu qeverinë e Enver Hoxhës në Shqipëri. Edhe me parashuta kanë ra grupe ka pesë parashutista, vena-vena nëpër Shqipëri, për me kriju atje organizatën për me rrëzu Enverin. Kanë qenë me uniformë angleze, i kem fotografinë e Cenit, uniformë angleze. Edhe po na tregon Hysen Terpeza tha, “Paskan ra këta dikun ka Peshkopija me parashuta”. Edhe në çdo grup kish qenë ka ni person i Shqipërisë, për me i gjetë atje konakat, domethanë venat ku m’u strehue.

Ai personi i Shqipërisë kur kanë ra me parashutë e ka thy komën edhe ai ju ka tregu rrugën ka me shkue edhe ju ka thonë, “Lemni mu këtu”, se veç ka fillu rrethi i ushtrisë së Shqipërisë me i rrethue, se i kish pasë tradhëtu ni ambasador i Rusisë në Angli ketë operacionin që ka pasë me ndodhë në Shqipëri. Edhe Ceni i jonë ka thonë, “Na nuk mujmë ty me të lonë këtu”, edhe ai e ka marrë në shpinë. Ky o rrëfimi i Hysen Terpezës. Edhe kur kanë mrrë te ni urë, te ni rekë, aty paskan luftue gjatë edhe aty paskan vdekë. Mas dy dite që jemi kthi prej Hysen Terpezës, e kish çu Hysen Terpeza djalin e vet me na thonën që, “Ceni vorrin e ka në Dibër”. Mirëpo, na sun e kena gjetë ose s’po tregojnë ata të Shqipërisë.

Anita Susuri: Në Dibër të Shqipërisë a?

Bajram Zymeri: Po të Shqipërisë, se këta s’kanë mujtë, kanë ra në Shqipëri, te Peshkopia, Peshkopi i thojnë edhe Dibrës ata. Kryesore, djali i Hysen Terpezës na tha neve që vorrin e ka aty.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Zoti Bajram, më tregutë ma herët për Teknikën Popullore, keni shku kështu si ndihmës, qysh ka shku pastaj qysh osht’ zhvillu qajo dëshira, dashurija për teknikën?

Bajram Zymeri: Aty une, u mbajshin aktivitete të ndryshme, si në foto-teknikë, si në kino-teknikë, si në radio-teknikë. E tash une isha në dilemë me çka m’u kapë, me foto ishte shumë ma lehtë a din ma... se e pata marrë ni aparat “Smena” sefte. Osht’ interesant ni aparat i vogël rus, ama i ka jashtëzakonisht të kfaritetshme i jepë fotografitë a din. Ja pata nisë me to, e edhe më interesojke elektronika jashtëzakonisht shumë, edhe isha në klasën e gjashtë fillore. Aty në Teknikën Popullore u pregaditshin nxanësat e të gjitha shkollave të Gjilanit për garat komunale edhe për ma tutje. Edhe une aty isha sikur ni zot i shpisë në atë, edhe pse isha i ri a din, në atë Teknikën Popullore, se e kisha vëllaun sekretar aty, m’u dokke...

Edhe ka qenën ni, në tavolinë kanë qenë të vendosuna të gjitha pjestë e ni radio aparati, të gjitha pjestë e ni radio aparatit. Kanë qenë dikun 36-35 tela me “krokodillka”, i kena thonën të metalit në çdo dy anë të telit, e me ato u dashke me i lidhë të gjitha pjestë të radio aparatit, se ato pjestë u patën vendosë në tavolinë kështu, e tash me i bo lidhjet, edhe me knu radija. Une i kqyrsha ata qysh u pregaditshin, të gjitha shkollave, kur shkojshin ata t’i hijsha une me ushtrinë. Edhe për çdo ditë ushtrojshe, kur erdh koha me shku në gara, tash ishin ka katër vetë të çdo shkolle, e tash ka dy u dashke me u zgjedhë për gara. Edhe erdh rasti i shkollës time, “Musa Zajmit”, me u zgjedhën prej atynve katërve, dy me shku në gara.

Unë p’i thom atij instruktorit që i mësojke ata, kërkush s’e dijke që une kom ushtrinë, edhe filloi i pari me montu ai sun e boni për 20 e kusur minuta sun e lidhi. I dyti qashtu, njoni sun e lidhi hiç, njoni ashtu. Une p’i thom atij instruktorit, i thashë, “Masi jom nxanës i qisaj shkolle, a bon”, thashë, “edhe une me hi në garë? Edhe une jom nxanës i asaj shkolle?” “Po more”, tha, “pse jo?” Une e pashë ku jonë ata. Edhe une dikun për gjashtë minuta e diçka e kryjta. Të plasi problemi, tash [në] vend se dy me ra prej tyne, u dashke me ra tre vetë, veç njoni mujke me ardhë me mue në gara. Ja nisën me qajtë, ata ishin të klasës të shtatë, une isha i klasës të gjashtë. Edhe, tre bishin tash, jo dy. Ja nisën me kajtë, u bo hallakamë, “Hajde p’e përsëritim edhe nihere”, une thashë, “Nuk e përsëriti”, thashë, “se une ju kom në xhep juve”, thashë, “ju munëni me bo gara nërmjet veti cili po vjen me mue”.

Ata ja nisën m’u ankue, ai instruktori tash s’dijke çka me bo se une s’kisha ushtrinë. Edhe shkoi e pyti arsimtarin e BAT-it, domethonë, Bazat e Arsimimit Teknik të shkollës. Po i tregon rastin, “Jo more”, tha, “neve na intereson kush osht’ ma i miri, ai osht’ nxanësi i shkollës tonë. Për mu”, a din, tha, “automatikusht vjen”. Edhe shkumë në gara komunale, une e zuna venin e parë, shkumë në gara krahinore, une prapë isha ma i miri. Edhe s’u gutsha une, se dikun dy minuta e bojsha, për dy minuta, qaq shpejtë e pata perfeksionu edhe me i bo ato lidhjet që mos me ta marrë menja. Edhe në gara federative e kom thy rekordin, për ni minut e 27 sekonda {ngritë gishtin tregues}, ishte diçka e pa imagjinushme, isha nxanës i klasës së gjashtë. E ajo manej më entuziazmoi edhe ma shumë me punue, edhe kom marrë pjesë në shumë gara, në Slloveni në Ljubljana, në Kroaci, në Bosne, kahmos.

Po ja u tregoj ni rast osht’ pak si qesharake, a din, ishmi në Slloveni edhe mas darke dulëm me shëtitë në qytet. Vëllau e kish marrë ni djalë të vetin me veti atje edhe po shëtitmi. Po thotë ai djali i vëllaut, Hysen e ka pasë emrin, po thotë, “Kush din me më tregu sllovenisht qysh i thojnë çajit?” Na ja nisëm krejt edhe kërkush s’e dijshmi. “Bre, çaj, bre, tea”, thojshmi mos anglisht si, hiç, “Jo”, thojke, “s’pe dini”. “Po qysh i thojnë bre hajde tregona Hysen?” Tha, “Repete”. Ai repete osht’ me u përsëritë, se kur lypshin fëmija ata në gara që ishin, çaj për s’dyti i thojshin, “repete”. Ky djali e kish marrën kishe i thojnë çajit, “repete”, edhe e bona si humor pak me asih, a din. E kanë qenë interesant, se kur shkojshmi në gara ishte interesant, e mu më ka ndihmu ajo. Për herë të parë që kom xhiru film osht’ me ni kamerë kësi e thjeshtë {tregon perball}, osht’ interesante.

Anita Susuri: Qe nëse doni... {i jepë kamerën}.

Bajram Zymeri: {Merr kamerën në dorë} Osht' shumë e thjeshtë, domethanë s'ka bateri, s'ka kurgja, kurdiset sikur me zemelek, sikur ajo e orës {kurdís kameren} edhe punon.

Anita Susuri: Ju për veti e keni siguru këta?

Bajram Zymeri: Këta në '66-tën dikun, '66. Pastaj, më hini qysh me thonë në gjak me inçizue. Me këta kom xhirue, domethanë tanë kohën me qit' kamerë kom inçizue. Pastaj kur veç i bona dikun 16-17 vjet fillova me i përgaditë këta ma të rijtë, fillova edhe si instruktor me punue me nxanësa, si në radio-teknikë, si në foto... kino-teknikë. E në '79-tën, jo në '78-tën, e kom ble kamerën e dytë, ni kamerë. Ni person erdh prej Amerikës, bile osht' gjyshi i Genta Ismajlit, e kish prue [kamerën]. Mas shumë vjete kish ardhë në Gjilan edhe me vizitu familjën edhe [ata] nuk kishin ditë me përdorë, se ai vetëm e kish ble edhe {merr kamerën tjetër në dorë}, s'dijke. Erdh me vëllaun e tina, une punojsha në atë kohë në shtëpinë e mallërave edhe po më thotë, "Bajram, e ka pru vëllau ni kamerë", edhe më tha, "s'po dijmë me punue". Ata e dishin, domethonë gjilanasit e kanë ditën une që mirrna aktivisht me këto punë edhe une i mësova.

Kur i pashë për herë të parë, se këto kanë qenën Patton [brand i kamerës], filma tre minuta, edhe kjo tre minuta {prekë kamerën}, mirëpo, kjo me Metton [mbajtëse] mujshe me inçizue. Zonin domethonë, me za mujshe me inçizue, edhe kur e kom pa më kanë metën, sytë më metën në to. Për atë kohë ishke... edhe p'i thom, "Sa e ke ble?" Më duket më ka pasë thonë, "800 dollarë", p'i thom une, "A bon kur të kthehesh, a e merr ti me veti kamerën kur shkojsh?" Tha, "Po". "A bon", thashë, "ti me ma shitën kamerën? Edhe prapë e blenë ti në Amerikë, masi po shkon në Amerikë, une sun e gjoj këtu kit kamerë. A bon me ma dhonë?" Tha, "Bon". Edhe e kom ble. Masi ka shkue ja ka lonë vëllaut edhe e kom ble. Edhe isha shumë i kënaqun, kom inçizue shumë, filmat kanë qenën Kodak⁵. Kur i blejshmi filmat ato e kanë pasë edhe zarfin qysh me thonë filmin me shti në to edhe veç e lshojshmi në postë. Shkojke në Gjermani filmi, e zhvillojshin, edhe ma kthejshin me postë, pa kurrëfarë pagese. Ka qenë me film që e blejshe, pagesa e kryme për zhvillim e për krejt.

Anita Susuri: E filmin ku e keni gjetë?

Bajram Zymeri: Filma ka pasë me ble këtu, filma nuk u konë problem me i ble. Mirëpo, me i zhvillu këtu s'mujshmi kolor [me ngjyra] me i zhvillu, se kolor fillova me inçizue, edhe i kom zhvillu shumë filma kolor. Mirëpo, '86-tën-'87-tën, kur filloi me u acarue situata [politike] në Kosovë mo nuk m'i pranojshin filmat në postë me i çue në Gjermani, se u frigojshin mos ka diçka propagandistike apo çka po di une. Edhe një ditë prej ditëve, e kisha ni shok në Gjermani, po i thom, i kisha 22 filma pa zhvillue, p'i thom, "A po m'i merr qita filma si të shkojsh në Gjermani? Veç lëshoji në postë, kurgjo s'pagunë, edhe mu më vijnë filmat në Kosovë", edhe m'i murr filmat. Kur më erdhën filmat, filmat ishin konë krejt të zditun. Domethanë, kurgjo s'ka në to, çka ka ndodhë?

⁵ Kompani amerikane e teknologjisë që prodhon produkte të kamerës fotografike.

Ai ka harrue me i nxerrën në kufi filmat, se i kanë rrezatue në carinë, as mu s’mu ka kujtue, as atina që mos m’i shtie ka rrezatimi, mos m’i shti filmat. E kom pasën dasmën tem të inçizume, kom pasë prindtë, kom pasë {numron me gishta të dorës} diçka e paimagjinushme. Krejt ato kujtime m’u kanë shkri në ata filma. Osht’ ni... ka qenë ni humbje e madhe për mue, s’mujsha me marrë me mend me i hupën 22 filma. Për budallaki, po thom, se s’u konë budallaki. S’mu ka kujtu as mu as atina, po ashtu me ndodhë.

Anita Susuri: Bash deshta me ju pytë, çka keni inçizu ma shumë, domethonë çka ju ka interesu?

Bajram Zymeri: Une ma tepër jom marrën në mënyrë amatore, domethonë une vetën e kom qujtë amater, po menoj jom marrë me amaterizëm. Domethonë, une ma tepër familjën, rreth familjës, shoqërisë, kështu, nuk kom inçizue profesionalisht edhe përveç... nuk e di a e kom cekë ma herët, ni vjet kom inçizu për Radio Televizionin e Prishtinës.

Anita Susuri: Jo, veç kështu na keni tregu para intervistës.

Bajram Zymeri: Eh, dikun në ‘74-tën gazetar korrespondent në Radio Televizionin e Prishtinës ka qenë Nexhip Bejta, edhe ai t’u më njoftë po më thirrë edhe po më thotë, “Bajram, a kisha me ardhën si xhirusë i jemi për Televizionin e Prishtinës?” Thashë... në realitet, ai edhe vëllaut i pati thonë, po vëllau s’kishte mundësi se ishte në kombinat i msheltë. Edhe thashë, “Po more, Nexhip, po vi”, edhe ni vjet e tepër kom xhirue për Televizionin e Prishtinës për Nexhip Bejtën si gazetar. Edhe ai po më thotë ni dite, “Hajde konkuro, u shpallë konkursi për ni kameraman në televizion”, edhe une u hapë konkursi edhe konkurova në Radio Televizionin e Prishtinës për kameraman.

Ishum në testim, na thirrën në intervistë ishmi katër vetë, bile në komunkim nërmjet veti na kandidatët, a din, e vëreja që s’kishin ata fort njohuri të fortë, a din, po të drejtë konkurimi ka secili. Edhe, kur hina aty po më pysin për inçizime, për krejt ato, çfarë kuadri, çfarë... krejt, kuadri amerikan, krejt rradhë a din, edhe une po i përgjigjina, a din. Edhe, ishke edhe Ekrem Kryeziu aty, ishte një ndër ata në komision, po më thotë Ekremi, “Ku p’i din ti këto?” Thashë, “Vallahi”, thashë, “mirrna që disa vjet”, thashë, “në mënyrë amatoreske”. Thashë, “që ni vjet jom t’u xhiru”, thashë, “me Nexhi Bejtën për Televizionin e Prishtinës, plus”, thashë, “për çdo muj”, thashë, “e marrim revistën Foto Kino Teknika prej Zagrebit”, thashë, “na vjen edhe lexojmë, e asihmi”. Thashë, “Përndryshe, nuk kom të kryme profesionalisht kurgjo për kamerë”. Edhe nuk më pranunë, e pranunë ni djal të Deçanit, tash sa ka ditë unë s’jom konë aty mrena a ka ditë a s’ka ditë, kryesore mu s’më pranunë.

Unë shumë u demoralizova, se ishte çashtja që shkojshmi edhe në Poloni me kry tanaj për kamerë, se Polonia ka qenë qendër për studime të kamerës. Edhe u dëshpërova edhe shkova ushtar. Ushtar kam qenë ni shkollë për teknik i mjeteve me frekuenca bartëse, kam qenë ushtar, une kom qenë në shkollë, në atë profesionin tem elektronik, domethanë për riparimin e mjeteve me frekuenca bartëse. Aty kom

qenë katër muj edhe më dërgunë në Split me një qendër të lidhjeve 500 metra në barkin e kodrës ka qenë ai objekt, pesë kat ka qenë në tokë. Une e kisha për detyrë me i mirëmbajtë ato kanalet, i kom pasë dikun 127 kanalla telefonik me i mirëmbajtë. Bile, dy kanë qenë atëherë të kryetarit të shtetit të Titos⁶, që s'kanë guxu asnjë sekond me u ndërpre.

Osh⁷ ni rast interesant, e prunën ni aparat se kanë qenë lidhjet ajrore edhe me tela, edhe domethonë me dy tela mujshin m'u bo 48 biseda telefonike mos me i pengu njoni-tjetrit. Edhe e prunën ni aparat, se në kohën e stuhisë e asi ndodhshin me u këputë telat, na e kishmi ni aparat onmetër, i thjeshtë osh⁷ ai aparat onmetër, me i matë për afërsisht, po gabimet u bojshin me dhetëra kilometra s'mujshje ti me caktu taman ku osh⁷ këputë teli. Ata e prunën ni aparat për me kqyrë teli ku osh⁷ i këput, në një mijë kilometra plus minus dy metra mujke m'i gabu ai aparat {ngritë gishtin tregues}. Edhe e provunë, une edhe i shiqova ata u mbledhën eprortë kur e prunën atë aparat, une e kqyra se qysh po funksionon, edhe na thanë, "S'guxoni me i tregu asnjë njësisë ushtarake që e kemi këtë aparat edhe ju ushtartë s'guxoni me e prekë", na thanë ashtu. Une aty punojsha katër ndërrime, domethonë ishmi katër ushtarë që punojshmi me ndërrime, ndërrimi i parë gjithmonë isha me eprorin tem.

Ni ditë, mori mot shumë i keq, ata i thojshin, "bura", e detit adriatik ajo... sikur këto stuhitë në Amerikë qysh bohën domethonë ishte një kohë shumë e keqe, dikun masdite prej orës 2:00. Edhe dikun ka ora 4:30 [masdite] po më thirrë ni kapter⁷ prej Mostarit po më thotë me i çu ushtartë se u këputë lidhja Split-Mostar edhe këputja o dikun në Split, "Me i çu ushtartë m'e gjetë ku osh⁷ këputja". M'u dhimshin ushtartë se koha e keqe, shka me boe? Ta marr une atë aparat, edhe e mata, kur e mata po më del në Mostar këputja. Tamon me kilometër, me metra e caktova, se e kemi pasën hartën mujshmi çdo ven me metra me caktu ku osh⁷. Edhe, une e kom matën, edhe jom shku te kujdestari dispeqer p'i thom, "Qishtu qishtu, më ka thirrën kapitani, une e kom konstatu që osh⁷ në filan ven këputja, edhe mu", thashë, "po më dhimen ushtartë me i çu palidhje nëpër kit mot të keq nëpër mal". As s'boni zo, une e morra edhe e shkrujta {përshkruan me duar sikurse shkruan në letër} raportin e kemi pasë ditarin, edhe e kom shkruar detalisht çka osh⁷ në pyetje.

Edhe, dikun 15 në 6 [masdite] po vjen eprori jem, pej Splitit, se u konë dikun 15 kilometra prej Splitit ai ven. Erdh, une u çova i dhash raport, i tregova çdo gja se e kemi pasë edhe obligim ata, p'i tregoj ai tha, "Bajram", tha, "nëse s'osht⁷ qishtu qysh po thu ti, bërlllog e ke bo punën", ishke përnime se e kom refuzue eprorin, urdhnin e eprorit.

Anita Susuri: Po.

⁶ Josip Broz Tito ishte udhëheqës politik jugosllav që shërbeu si president i Jugosllavisë nga viti 1945 deri në vdekjen e tij në vitin 1980. Ai luajti një rol të rëndësishëm në bashkimin e grupeve të ndryshme etnike të Jugosllavisë, dhe udhëheqi vendin gjatë një periudhe relativisht stabile, duke zbatuar një formë unike të vetëadministrimit socialist të cilin e zbatoi si një aspekt themelor të sistemit ekonomik dhe politik të Jugosllavisë.

⁷ *kaptër*, term në ushtri, gradë nënoficeri, më e lartë se rreshteri.

Bajram Zymeri: Edhe, pa njo pa dy, u shku e ka marrë aparatën edhe e ka marrë, e ka matë, ni metër kish luftën une qysh e kom vizatu. Veç u shkue, ka hypë në katin e tretë ka qenë, kapitan Fregate kujdestar, ai 24 orë nuk dalke prej objektit. I ka tregu që, “Qishtu qishtu”, edhe ka zhdrypë eprori jem poshtë, e ka thirrë atë kapetanin, s’ka lonë gjo pa i thonë, a e shajti, a... tha, “Ushtari jem osht’ ma i dijshtëm se ju eprortë”, e boni hallakamë. Une tash kisha bo gabim që e kisha matë me aparat, se kom pasë urdhërin që s’guxon me prekë. Nuk boni zo eprori hiç, as s’më veti, “Qysh e ke konstatu?” As hiç, hiç, hiç. Ai e dike qi veç me aparat, se me metër s’ka shancë teorike me e konstatue.

Edhe po më thirrë të nesrit ai kapetani, “Qysh e ke ditë”, thojke, “ti, që në filan ven osht’?” I thojsha, “Me metër e kom matën”, unë s’i kallxojsha për këta. Thojke, “Mos rrej se osht’ e pamundun”. “Ah bre, une qashtu e kom matë”. Edhe ni ditë, ai eprori jem po thotë do kraha qishtu të pllaskës i vyjshin për ato, do farë parica i thojshin, tha, “Sun po gjojmë kërkun me...” kur p’e kqyri unë ato të thjeshta ishin konë. Thashë, “I marojmë bre” “Jo bre”, thotë, “qysh i maron?” Thashë, “Qe me qit vizore të pllaskës”. Kishmi, mjetet i kishmi, i kemi pasë ato sharrat, i kemi pasë krejt a din.

Anita Susuri: Për çka jonë këto pajisje?

Bajram Zymeri: Jonë me i nda lidhjet, për shembull e shtin ndërmjet edhe i ndanë kontaktet, e shtin atë krahnin, si krahnin me tri u konën asi. Edhe mu m’u dokke thjeshtë shumë, a din, thashë, “Qe bre me qit vizore i maroj”. “Qysh bre i maron?” Thashë, “Une i maroj”. Na vyjshin 80 copa. “Qe”, tha, “merre provoje n’ mujsh me i maru”, me qatë vizore ja marova dhetë copa që s’ mujke me besu qi mujnë m’u maru. Kur i kryjta, tha, “Bajram”, tha, “i ki dhetë ditë shpërblim”, tash ishke ajo çashtja e atij aparatit edhe këto që ja ndreqa. E po thotë, “I ki dhetë ditë shpërblim”. Edhe, p’i tregoj qiti vëllait, se kit vëllaun ish të burgosun e kena pasë si kryesorin në familje, p’i thom, “Agi”, thashë, “m’i kanë dhonë dhetë ditë”, amo ai eprori më tha, “për fund, kur të shkojsh te shpija, dhetë ditë para kohës me shku”.

Vëllai po më thotë, “S’ti jepë vëllau jem, po në mujsh me ja marrë”, tha, “merrja qitash”. “O vlla”, thashë, “më ka thonë qashtu, tash qysh m’i thanë une?” Edhe une e menova ni trik, ni dite se ishmi pesë-gjashtë orë bashkë rrishmi në tavolinë, se nër tokë s’kishe ku me shkue. Edhe u bona në mazunë, ai më vërejti, a din, tha, “Çka ki?” Thashë, “Nonën e kisha të smutë në spital”, thashë, “më thanë që s’osht’ kumeditë sa e smutë”, po thashë, “a e din nihere kur s’e sheh”. “A po don”, tha, “me shku te shpija?” Une menxi që pritsha. Tha, “Shtatë ditë i kie. Nesër”, tha, “pregaditu shko për Gjilan”. Gjuhën sërbo-kroate e kom ditë jashtëzakonisht mirë edhe sot e di.

Edhe, përndryshe aty edhe kom montue centrala telefonik edhe erdh situata në 1979-ën u majke Kampionati Botëror i Femnave në Handboll, s’e di a e dini? [i drejtohet intervistuesës] 1979. I patën marue hallat e sporteve në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, krejt i patën maru hallat e sporteve se u majka kampionati botëror, në atë kohë ‘79-ën u konë pak... edhe semaforat aty ku del rezultati e sekondat që shkojnë {përkshkruan me duar tabelën} jonë konë të mëdhaj, në qosh të

hallës u konë, i kishin ble prej italianëve. Edhe, montimin Iskra [kompani] e Kroacisë e kish caktue industrinë elektronike të Nishit me i montue.

Ata e kishin pasë montue gati krejt veç Gjilanin edhe Ferizajin s’e kishin pasë montu, kishin pasë deshtën me sabotue Kosovën, Nishi, që qe, “Kosova s’osht’ në gjendje me organizu ni diçka të madhe”. Edhe na thirrën këta komunartë vëllavin edhe mue, “A muni me montue këtu në hallën e sporteve, me montu semaforin [për lojra sportive]? Këtu në hallën e sporteve me ndërto semaforin”. Na thamë, “S’kena montu kurrë, po p’e provojmë”. Edhe vëllau e murr edhe ni punëtor çka e kishte aty në kombinat me veti edhe fillumë. U dashke, se ishin gati 400 tela, për shembull pej tavolinës ku jonë delegatët deri në semafora atje, u dashke me i ditë secilin ku me vnu, me kallaj me i ngjijtë, me asi, ishke punë, gati gjashtë ditë kena punue derisa e kena montue.

Tamon e kena krye ata, ishte dita e ejte, po na thirrin prapë këta komunartë. Shkumë në Komitet, na thirri Komiteti atëhere u konë kryesore për çdo gja, shkumë aty ish ardhën Mehmet Maliqi, ka qenën ministër i Punëve të Brendshme të Kosovës, baba i [Shkëlzen Maliqit](#) në qoftë se e dini këtë gazetarit. Ai ka qenë ministër i Punëve të Brendshme, po thotë tha, “A bre djem ju e kishit montue semaforin në Gilan?” “Po”. Thotë, “Duhët me shkue me montu në Ferizaj”. Ishke e ejte, të honën loja e parë lujke në Ferizaj në ora 10:00. “Vallahi s’e di a mujmë e mrijna na, këtu s’jena gutë nime fort”.

Edhe na i premtoi në atë kohë për te dy semaforat edhe për të Gjilanit edhe për të Ferizajit, dikun në vlerë të gjashtë mijë markave. Të shtunën në ora 8:00 kemi qenë në hallë të sporteve në Ferizaj, ja kemi fillu me punu, amo na këtu punojshmi ka katër-pesë orë, shkojshmi te shpija, aty s’kishte ndërpreme. Kryetari i Komunës të Ferizajit u kujdesë për neve, a na i ka pru bukën në drekë, a në darkë a, a çaj, a çdo gja, veç mos m’u largu prej punës. Domethonë, të shtunën ja kemi fillu në ora 8:00, të dillën proma në ora 3:00 të natës e kemi krye. E kemi lëshu me punu, s’punon.

E i murrëm në bela, e i kemi hi shpejt e shpejt edhe nihere, dhe e konstatumë për afërsisht që mikseta nuk osht’ në rregull, se kjo puna na çka e kena punu osht’ në rregull. Kryetari i Komunës e ka marrën shoferin e vet e ka pru në Gjilan, e kanë marrë miksetën e Gjilanit, e kanë pru në Ferizaj, kur e kena vnu miksetën e Gjilanit, po punon. E ka çu tanaj ka ora 4:30 shoferin për Shkup, me marrë ni miksetë përmas edhe na e bonëm për 48 orë gati semaforin.

Anita Susuri: E mikseta qajo...

Bajram Zymeri: Mikseta osht’ ku i bon regjistrmet aty në tavolinën e... domethanë vjen koshi, ky e shkrinë, a din, ose sekondat sa kanë m’u lujtë krejt prej qasaj, në qatë miksetën bohën. Edhe kom mbrojtë unë nja ni vjet handboll për “Bozhurin” e Gjilani, edhe qe dola edhe në sport (qeshë). Edhe, vendosëm masi isha i interesunë edhe lojë ndërkombëtare, lujke Suedia me... s’e di me cilin shtet në Ferizaj, e vendosëm me kqyrë lojën, masi veç ishke dikun ora 8:00 e diçka [në mbrëmje], 8:30, në 8:00

fillojke me hie publiku në sallë të sporteve, na ishmi ty pregaditë ato haletet tona, tu asih, edhe e vendosëm me kqyrë lojën.

Kur une po lypi ni ven, a din, për me kqyrë lojën, kur erdh ai i punësumi i hallës së sporteve ni person, po më thotë, “Çka po sillesh?” Thashë, “Po kqyri ni vend me kqyrë ndeshjen” “A ki biletën?” Thashë, “Jo, s’kem biletë” “Hajde”, tha, “dil jashtë”. Thashë, “Jo mor”, thashë, “që 48 orë pa gjumë, pa kurgjo”, thashë, “kom punue, me mujtë m’u lujtë qikjo lojë qitu”, thashë, “mos ja nxjerr bishtin”, thashë, “une lojën kom me kqyrë”. “More”, tha, “kush po të vetë. Dil jashtë!” “O ti jaran, ti a p’e din që kena punue, kena asihe”, thashë, “për me u lujtë qikjo lojë”. Tha, “Hiç s’më intereson. Dil jashtë edhe pikë. Dil jashtë, dil jashtë!” Jom shku te vëllau edhe p’i thom, “O vëlla”, thashë, “s’po na lojnë me kqyrë ndeshjen, na biletë s’kemi”, thashë, “kena punu që 48 orë po thojnë dil jashtë edhe kurgjo kërkujna”. I kemi mbledhë haletet, i kemi shti në kerr edhe jemi nisë për Gjilan.

Ndërkohë, ka ardhë kryetari i komunës, ka vetë për neve, “Ku jonë?” “Vallahi”, tha, “u idhnunë diçka, shajtën edhe shkunë për Gilan”. E ka marrë shoferin në Tankosiq na ka zonë {ngritë gishtin tregues} kryetari i komunës të Ferizajit. *Tap* {onomatope} na dul përpara kerit, “Çka u bo?” Thashë, “S’na lanë, na përzunën prej hallës së sporteve”. “Kush bre guxon”, tha, “me ju përzonë juve? Me u kthye me u asi”, na s’u kthymë, vazhdumë për Gilan. Masi na e bonën qato aty tham mo {përshekruan me duar në shenjë përfundimi}... a qaj punëtori që na përzuni ish konën vëllavi i grujës të kryetarit të komunës, mirëpo atij i erdh keq kryetarit të komunës. U konë rasti interesant.

Anita Susuri: Juve s’ju ka njoftë?

Bajram Zymeri: Jo mor, une i tregojsha, i asishsha, po s’ishke me randësi mo. Kryesore ma prishi qefin, domethanë ishmi pa gjumë, ishmi asi, kryesore ja kryjtëm. Edhe kurrë s’na i kanë dhonë ato gjashtë mijë marka {ngritë gishtin tregues} (qeshë). Po komunizëm u konë, s’guxojshë me çu kry se të sakatojshin.

Anita Susuri: E zoti Bajram, ju a keni vazhdu fakultetin? Përmendët diçka...

Bajram Zymeri: Vetëm ni vjet e kom krye. Vitin e parë fizikën, mo s’kom vazhdue

Anita Susuri: E shkollën e mesme në cilën ke?

Bajram Zymeri: Në gjimnazin, “Zenel Hajdini”, gjimnaz.

Anita Susuri: Thatë pastaj që keni qenë të angazhumë në teatër, ke punu edhe për teatrin?

Bajram Zymeri: Domethonë, punë jo, ai ka qenë aktivitet amator, s’kom punu une amo kemi qenë anëtarë të teatrit. Përndryshe, nja dy role kom lujtën ma tepër, po une s’e kom pa vetën si aktor. E une

ma tepër atë anën teknike muj me thonë, zërimin e kom bo për shembull të dramës, edhe fotografitë i bojsha për reklama të teatrit. Dikun ngat dymdhetë vjet une i kom bo fotografitë për...

Anita Susuri: Në cilin vit keni fillu?

Bajram Zymeri: Une kom fillu në '72-tën, domethanë prej '72-tës, 22 vjeçar. Ekzistojnë fotografitë atje në teatër, jonë ato fotografitë krejt aty.

Anita Susuri: Ju i keni përgaditë këto reklamat?

Bajram Zymeri: E reklamat tjetërkush i ka pasën, une veç fotografitë. Une fotografinë e kom boe edhe i kom fotografue, ja u kom maru fotografitë, ja u kom ndërrue, e tanaj kanë qenë ato reklamat që shtypshronja i ka bo. Edhe ato për shembull kanë qenë panotë para teatrit {përshkruan me duar formën e kornizës}, të mëdhaja, aty i vnojshin fotografitë. Për shembull, kur reklamojshin që drama luhët në filon ditë në ora qikaq edhe i reklamojshin me ato. I vnojshin fotografitë edhe i vnojshin atë panonë e roleve, e atyne asi, edhe njerëzija tana i pahke edhe aktorët në fotografi edhe krejt ato. Me teatër kena udhëtu shumë, ka qenë aktiv Teatri i Gjilanit, jashtëzakonisht. Tanaj u shpall [teatër] gjysëm profesional, ishte kënaqësi kur shkojshmi jo vetëm në festivale, po na kena shku edhe në shfaqje edhe kështu nëpër krejt Kosovën, Maqedoninë, në Dibër, ku ka popullatë shqiptare sidomos.

U knaqshmi në autobus, për shembull, shoqni, edhe kjo u konë ni kënaqësi e madhe, a din, ni relaksim i madh i të përditshmës, se tana une në '76-tën mo fillova me punue pasi që u ktheva prej shërbimit ushtarak në ndërmarrjen tregtare "16 Nandori" fillova aty me punu. Aty kom punue në shtëpinë e mallërave dikun dy vjet edhe ni ditë prej ditëve po më thirrë ni drejtor i kombinatit të tekstitit, të fabrikës të xhemperave, po më thotë, "Bajram, a kishe ardhë me punue në fabrikën e tekstitit? I kena marrën dhetë makina për punimin e xhemperave", me ato dizajnet e ndryshme që jonë, me lula që dalin xhempera me, e tha, "Jonë elektronike, e ti me mirëmbajtë elektronikën e atyne maqinave".

Thashë, "Çfarë kushte po më jepë?" A din, kur ma tregoi rrogën, ishte tri herë ma e madhe se këtu ku punojsha në "16 Nëndor". Thashë, "Tjera kushte a ka diçka?" Tha, "Edhe ni banesë po ta japim", ishte... Tash po konsultohna une me kit vëllaun që të thashë e kom, e kemi pasë krejt si idiator, lider. I thom qishtu-qishtu, se edhe ai ka punu në atë kohë në tekstil, bile do ta tregoj osht' interesant ni rast qysh ka ardhë aty. Tha, "Bajram", tha, "lypja ni pllac ma mirë se banesë, ty prej banesës nesër të qesin të asihin, a pllacin nëse e qet përmi veti", tha, {përshkruan me duar kinse kryhet ajo punë}. Edhe e pranova, pranunë ata me ma dhonë ni pllac.

Ishte e ejte edhe po më thotë, "Shko", tha, "merre pushimin vjetor në '16 Nëntor' edhe hajde e bojmë kontratën mbi vepër për ni muj ditë këtu", domethonë marrëdhanye pune për ni muj, i thojnë kontratë mbi vepër. Edhe, "A ki pasosh?" Thashë, "Kom". "Të shtunën", tha, "ki mu nisë për Gjermani në specializim", pa pritë, pa kujtu hiç {përshkruan me duar në shenjë çudie}. Edhe jom shku e kom marrë

pushimin vjetor në “16 Nëntor”, jom shku e kom bo kontratën mbi vepër, të shtunën jom nisë për Gjermani, pesë vetë kemi shku, katër mjeshtër mekanikë edhe une elektro. Kur shkumë në Gjermani, s’ish konë për mue specializimi, po ish konë veç për këta të katërt. P’e thirri une kit drejtorin po i thom, “O drejtor”, thashë, “s’koka për mue”. “Hajt more”, tha, “rri atje mos më lodh”. Nejse, ama une e mësova edhe atë punën e tyne, bile ma mirë se ata, se une kisha edhe shkollë ma shumë se ata, ata ishin me shkollë fillore.

Edhe u kthymë, kur u kthymë, plasi ni mosmarrëveshje. Na në hotel atje kena fjetë, e kishmi gjysë pansioni domethonë fjetjen edhe mëngjesin edhe kurgjo tjetër. Edhe për atë arsye neve na takojke meditja e plotë, se me konën pansion i plotë atëhere ishke gjysmë meditje, ama masi na e kishmi veç mëngjesin atëhere neve na dilke, na u dashke meditja e plotë. Ishin pare të mëdhaja markat në atë kohë, edhe une veç e dijsa që duhet me ma dhonë të plotë. Une thashë, “Veç të plotë e due meditjën për ato tri javë ditë”. “Jo, s’munët qe anej knej”, s’e di çka kursejshin ata me atë gjysmë meditje, amo s’dojke me na dhonë.

Këta katër shujshin nuk bojshin zo, “Jo”, thojshin, “neve na qesin prej punës, na jesmi pa punëm ti nuk jet pa punë se ti gjonë punë”, thojke, “ti për qata edhe po qet kanun”. “O shqiptarë, ju e meritoni me i marrë të plota”, bre ju fola, bre hiç s’murrën vesh. Edhe në fund, une e kom marrë të plotë, ata e kanë marrë në gjysë, pse nuk asishin... edhe qaty fillunë ato farë mosmarrëveshjet. Ky drejtori që isha kha në “16 Nëntor” po thotë, “Hajde po ta çeli ni shitore të specializume, vetëm pjesë të aparateve shtëpiake me shitë”. “Po”, thashë, “po ti s’ma jepë rrogën e atjehit”, unë thashë. Tri here e kisha rrogën ma të madhe. “Jo”, tha, “ta jap veç hajde”. “Po”, po thashë, “me ma pranu edhe çikën e vllavit me punu me mue aty në shitore”, edhe pranoi. Mirëpo, tana i ra pishmon.

Çikën e vllait s’ma pranoi, une u ktheva edhe e çela ni shitore të specializume. Të gjitha pjesë e aparateve shtëpiake i kom pasë, se atë drejtori e dijke që e njoh atë lami. Për shembull, prej hekurit, çdo gja të hekurit që hekurosë kom pasë, çdo gja të televizorit, s’ka pasë pjesë të televizorit që s’kom pasë, të shporetave, lavatriqeve, krejt i kom pasë ato. Prej Vrajës të Sërbisë, e deri në Pejë qaty jonë furnizu mjeshtërit në shitorën teme në atë kohë me pjesë të aparateve.

Anita Susuri: E ju ato pjesë ku i keni...

Bajram Zymeri: Shkojsha u furnizojsha për shembull në Nishë, në Lublanë, në Zagreb, në Sarajevë, në Maqedoni, krejt une kom shkue edhe i kom furnizue.

Anita Susuri: E ky dyqani a ka qenë në kuadër të...

Bajram Zymeri: Të ndërmarrjes, ajo krejt une veç rrogë kom pasë kurgjo tjetër, une veç punëtor jom konën, shef, a din, i shitorës jom konën. Edhe aty edhe e kom perfeksionu tanaj që më ka vyjtë në jetë, se serviserat vishin aty për aparate që i shitshim, se une i kom shitë edhe televizorat, shporetat, përpos

këtyne pjesëve, kom shitë edhe këto pjestë e mëdhaja. Për shembull, u prishke televizori, krejt vijshin te une u lajmërojshin kush ju prishke. Po ka ndodhë bon vaki ni muj ditë e ka marrë televizorin te une, une ja kom kthy, ja kom dhonë të ri në atë kohë. Se vijke serviseri te une aty në dyqan e përmisojke televizorin edhe prapë e shitsha, u konë pak ma asi... mirëpo, une e perfeksionova zanatin edhe ma shumë, sidomos për lavatriqe u bona mjeshtër i përkrymë, shporeta ato, se i njifsha elektronikën. Ai që e njeh, se elektronika osht' tensioni i ulët, i vijushëm, po une e njisha edhe tensionin e lartë, këta të rrymës qita e njifsha. E une shumë lehtë e asiha, edhe ju kryjsa asi, edhe antenën e parë satelitore në atë shitore e kom pru unë në Gilan.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: E përmendët edhe ndërmarrjen teknike që keni punu, a ka qenë kjo vetëm në Gjilan, a ka qenë në vende tjera në Kosovë?

Bajram Zymeri: Ka pasë, ka qenë teknika popullore edhe në Prishtinë edhe në Mitrovicë, edhe në Prizren. Ka pasë tanaj radio u patën çelë në Ferizaj, edhe në disa komuna tjera, se Teknika gjithmonë ka qenë e lidhtë me shkolla. Teknika Popullore ka qenë e lidhtë me shkolla, me i aktivizue edhe me i mësue nxanësat me njohuritë teknike. Bile, ma herët dikun viteve '60-ta, për shembull kanë bo gara edhe traktoristat për livrim, krejt ato i ka organizu Teknika Popullore, ka pasë lavërtari gara, ka pasë plotë lami, se në përgjithësi osht' marrë me edukim, jo shkollë, po edukim teknik kështu, po. Në shkolla s'ka pasë laboratore, s'ka pasë kumeditë se çka, e krejt ato antë praktike sidomos për antë praktike ka qenë Teknika Popullore. Në shkollë teorinë e kanë mësue, a në Teknikën Popullore i mësojshin gjanat praktikte.

Porositke, për shembull, Teknika [Popullore] turli maketa, turli asi, edhe vishin nxanësat aty u pregaditshin me bo turli roboti, turli. Bile, në aeronautikë i marrshin edhe do motorra sikur të aeroplanit, e i marojshin aeroplanat me stiropor, ose me thupra të holla të drunit e me ni letër si paus ja marojshin krahtë e ato, edhe fluturojke me atë motorr fluturojke. Edhe u majshin gara në aeronautikë, për shembull. Ka qenë ajo organizatë gjynah që nuk ekziston tash, se shiqo edhe sot ti nëpër shkolla nuk kie mësim praktik, a aty jonë boe krejt qito gjanat praktikte, aty praktikisht u bo, jo teoritikisht. Teoritikisht jonë mësu në shkollë pa teori edhe nuk ke mujtë me bo praktikën, amo praktikisht aty jonë bo.

Anita Susuri: Domethonë, shkollat kanë organizu grupe të klasave që i kanë sjellë aty?

Bajram Zymeri: Po ose i kanë sjellë ose kanë ardhë në mënyrë vetjake. Kanë mujtë nxanësat me ardhë, nuk ka qenën obligative kurgjo, nëse e ka ni vetën mos me dalë me lujtë nëpër... apo me shëtitë fëmija, e ka pru në Teknikë me u marrë me aktivitete teknike. Shumë, shumë prindë kanë prue fëmijtë e vetë aty për me u aftësu teknikisht. Ka qenë një metodë shumë e mirë, për mu barem, se për shembull,

une kom pasë rast se une isha mo, praktikën e kom njoftë, unë kom pasë rast me inxhinierë të elektroteknikës që nuk kishke lidhje me praktikë, e ka mësu teorinë në fakultet edhe mo kha s'dijke. Kur metëm pa punë, kur na largunë në vitet e '90-a, shkojshin profesorë e asi...në pazar punojke. Edhe merre me mend inxhinieri elektroteknikës më thirrke me ja riparu lavatriqën, osht' e dhimbshme ajo. Ose kurrë nuk e ka ndërru siguresën elektrike, a osht' ajo... e aty jonë mësu domethonë praktikisht çdo gja ka shkue, domethonë me durë ke asi {përshkruan me duar punimet me dorë}.

Anita Susuri: E krahas profesionit po du pak me folë edhe për jetën shoqërore. Si ka qenë atëherë kur keni qenë i ri, çfarë aktivitete ka pasë?

Bajram Zymeri: (Qesh) Vallahi, s'ka pasë kurgjo edhe aty, përveç, eh, korzo ka qenë në mbramje, e vetmja sa kom qenë për shembull në gjimnaz, u mbajshin ballot të shtuneve në mbramje. Për shembull, gjimnazi e ka pasë hallën e madhe, atë hallë i thojnë asaj pjesës të shprazët aty mrena, aty çdo të shtune gati osht' organizu ballo. Mirëpo, interesant o qi vajzat shqiptare gati nuk vijshin, rrallë, rrallë që vijke ndonji vajzë shqiptare. Na ishmi djemtë shqiptarë, a knejna vajzat sërbe vishin me mashkujt sërbë, se domethonë shkollat kanë qenë edhe shqiptare edhe sërbët klastë. E vijshin vajza e djem sërbë me vajza, vajza shqiptare s'kishke shumë... a vijke najnjo rrallë, shumë rrallë ka ndodhën, shumë rrallë.

E në korzo po, në korzo kanë dalë edhe vajzat me djem. Aktivitet në atë kohë korza ka qenën prej stacionit të autobusave deri në qendër te xhamija u bojke, në dy antë të rrugës kishke. Pastaj, pas ni kohe u ndajtën ana e shqiptarëve edhe ana e sërbve, veç fillunë ato farë problemet politike e asi, edhe u ndanë, njona anë ishte korza e shqiptarëve, njona anë korza e sërbve. E nuk ishte mirë, domethonë aty bojshmi, argëtim me thonën, shëtitje kurgjo tjetër.

Anita Susuri: E në këto ballot çfarë muzike ka pasë?

Bajram Zymeri: Muzika ka pasën edhe të jashtit argëtuse, popullore gati s'ka pasë hiç në atë kohë, në atë kohë jonë konë Beatles-at e këto ansamblet e ndryshme jonë konë botënore, sidomos jonë konë aktive, jo tango ose diçka. Ka pasën kryesore dikun tri orë, se u dashke tanaj e mbyllshin ata në shkollë, se në shkollë u majshin ato, nuk u majshin tjetërkun. E argëtim, qajo ka qenë argëtim tjetër...

Anita Susuri: E në teatër ju e përmendët që edhe keni punu në teatër, po a e keni vizitu a keni shiku naj shfaqje?

Bajram Zymeri: Po, po, po, mirë kur osht' shfaqë ajo shfaqja jonë na e kemi përcjellë prej mbrapa kulisave, mirëpo çdo shfaqje që ka ardhë na mo anëtarët e teatrit domethonë me pagesë jonë konë vetëm katër artista jonë konë të pagumë, tjetër jemi konë krejt amaterë, domethonë pa kurrëfarë të ardhuna, na kurrëfarë të ardhuna s'kena marrë. Krejt ka qenë vullnetare, na s'kena, për shembull fotografitë që ja u kom maru ata i kanë ble materialin veç, tjetër sen nuk kemi pasë ndoj financiarisht

ndojfarë interesi, a din. Krejt ka qenë në atë kohë vullnetare ka qenë çdo gja, nuk ka pasën asi. Çdo festival që u majke, na e kemi pasën aty byfenë tonë, domethonë në podrum, se ditën për shembull ma tepër masdite fillojshin provat e ato. Mirëpo, paradite shkoshmi aty pijshmi kafe ka qenë byfeja, rrishmi, argëtim, qata muj me thonë argëtim për shembull. Tjetër s'ka pasën.

Anita Susuri: E kështu që keni përcjellë shfaqjet, çfarë njerëz për shembull kanë ardhë ose naj përgaditje të veçantë?

Bajram Zymeri: Aaaa, shfaqjet për shembull gjithmonë jonë dhonën gratis dikun nja tri renat e parë, gjithmonë ju kanë çu në atë kohë ktyne penzionerave, jo asi, jo ndërmarrjeve dikujna, pjesa tjetër osht' ble bileta. Mirëpo, këtu ka pasë jashtëzakonisht shumë shikusë, gjithmonë salla ka qenë plot, gjithmonë ka qenë. Bile edhe kur u organizojshin koncerte, jo veç teatër, po gjithmonë, interesant qytetartë e Gilanit shumë e kanë vizitue si teatrin, si koncertet. Nuk më kujtohet viti kur patën ardhë Ansambli i këngëve, valleve, prej Shqipnisë.

Anita Susuri: '70 e diçka.

Bajram Zymeri: '70 e diçka u konë, '72 ose s'po di kur... ka qenë madhështore, dikun përmi 200 fotografi i kom pasë bo a ma tepër. Kurrë nuk e di a i kanë marrë a jo, se ja u pata çu me postë, nuk e di. Bile i gjeta do fotografi çka i kom fotografu atëhere. Nuk e di a i kanë marrë a jo, se une ja pata çu te njo të Ansambllit atëhere se s'kom pasë adresë kështu të veçantë, e veç ishke masi për herë të parë me pa prej Shqipnisë ni koncert ka qenë diçka madhështore. Tanaj për s'dyti të nesrit e organizunë në stadion, se qaq pat shumë të interesumë sa... na të teatrit kishim pak ma mundësi me u shoqëru me ata, se ishmi aty, se ata aty u pregaditshin e mujshmi për shembull, se edhe s'lojshin fort me pasë kontakte. Na pak diqysh si, për punë, rrishmi, u nalshmi, bisedojshmi me ta. Edhe pse edhe ata i kishin sekretartë e partive që s'i lejojshin fort, kuku ata bile ma shumë se na, ata ma tepër. Bile më kujtohet ni rast osht' interesant, ni profesor i gjuhës shqipe e kish pasë puthë tabelën e autobusit të Shqipërisë, edhe e patën burgosë. Çka m'i bo tash, ashtu ka qenë...

Anita Susuri: E çka keni mujtë me bisedu me ta për shembull...

Bajram Zymeri: Po s'ke guxu me hi kërka veç, "Çka punon? Qysh punon? A mirrësh, me çka mirrësh kështu në aktivitete të lira?" Nji bisedë shumë, shumë të thjeshtë, se edhe s'guxojshin as ata, as na. Po në atë kohë nuk, ishte... se ishte për herë të parë ajo kontakti me të Shqipnisë, e shumë shtirë u konën.

Anita Susuri: A ju kujtohet për shembull për pregaditjen e shfaqjës, qysh ka rrjedhë organizimi kur keni qenë ju si...

Bajram Zymeri: Po, se në Teatrin e Qytetit ka pasë edhe ato sallat e vogla ku për shembull ma së pari Këshilli Artistik e caktojke cilën dramë do të pregaditet, pastaj kur u caktojke drama rolet u dashke me i

da, simas rolit ishte edhe personi që do ta lunte atë rol. Tanaj fillojke mësumja e tekstit, jonë konën ato dhomat e mëdhaja ku u bojke leximi i dramës, domethonë secili tash e lexojke rolin e vet derisa u mësojke teksti. Kur u mësojke teksti, fillojke në skenë me dalën, lëvizjet me i bo, me i asihë, e krejt, regjiseri ato punë i bojke. Tanaj fillojke edhe pregaditja e skenës, çka do të ketë në skenë, krejt ato.

Kanë qenë dy punëtorë për pregaditjen e skenës, se aty u dashke jo turli dërrase, turli çkasmos, ato vizatimet e ndryshme, noj... Gjithmonë profesorat e artit i kanë bo ato, i marojshin ato panotë e mëdhaja mvarët çka, dera, dritarja, ku pe di une mali ato, krejt në mënyrë amatore. Vijshin profesorat për shembull, edhe diqysh ka qenë entuziazëm, a din, veç me, se ishte ni revolucion, se prej pasitivetit domethonë deri në vitet e '70-ta rrallë, vallahi nuk e di a i kom pasë, '62-tën apo '63-tën nuk e di, ka pasë ardhë Teatri i Prishtinës, Katarina Josipin⁸, une e kom pa në Gjilan, Katën. E vetëm kur vijke najhere prej Prishtinës, se kështu asi...

E kur u formue teatri i qytetit edhe njerëzit qytetarë e ndishin ni revolucion në atë ndërdijen e vet, që ishte ni... e papërshkrushme që po mund me shku në teatër e ishte ni kënaqësi e madhe. Une po thom, gjithmonë edhe jo vetëm ni reprizë, gjithmonë janë dhonë ma së pakti deri në pesë repriza janë dhonë. Domethonë, për pesë ditë ren kanë dalë që u bo repriza e shfaqjës, se kishte të interesumë. Po thom, për Gjilan po foli, nuk e di për tjera vene, këtu kanë qenë shumë të interesumë.

Anita Susuri: E këto shfaqje që keni thonë që ju morrët pjesë, cilat kanë qenë?

Bajram Zymeri: Une s'kom pasë, kom pasën "Familjen e Peshkatarit" kom lujtë rol, a në "Gjeneralin [e Ushtrisë së Vdekur]" nuk kom lujtën, në "Gjeneralin" e kom pasë muzikën edhe inspicient jom konë me sa e di, se u dashke me i tregu kur me hie aktori, kur me dalë, kur me asihë...

Anita Susuri: E muzikën qysh e keni, e keni caktu ju vet apo?

Bajram Zymeri: Muzikën na i ka përgaditë ni profesor i muzikës, e tanaj inçizimin e kemi boe edhe tanaj për shembull e kemi ditën kur e bojshmi ka qenë magnetofoni i madh ai edhe u dashtë me ditë kur me lëshue efektin. Për shembull, ka pasën efekte muzikore shumë, për shembull *bam* {onomatope} kërset alltija se s'ka pasë kështu këto me kërset me këto farë, po me inçizim u bojke. Për shembull, kur vijke [ai moment] u dashtën saktësisht me, shumë ka qenë precizitet i madh te muzika kur me lëshue, muzika *ta-ra-ra-ram* {onomatope e një efekti zëror në teatër} ose diçka. Çdo efekt muzikor u dashtë në momentin e caktumë me e lëshu. E u konë shumë me përgjegjësi, se nëse ai [aktori] ja bojke me allti, e nalke dorën me i kërset henez alltija. Ajo budallaki osht', ata s'kanë guxu me ndal.

⁸ Katerina Josipi (1923-1969) ishte aktore e shquar shqiptare që bëri histori si gruaja e parë që iu bashkua Teatrit të Kosovës në vitin 1948, ku veproi për 21 vjet. Përkushtimi i saj në karrierë la një ndikim të madh në botën e teatrit, ajo performoi rreth 80 role kryesore në teatër, dhe më shumë se njëqind role në dramat e radios.

E u konë ni përgjegjësi bajagi e madhe ajo, efektet muzikore, me “Gjeneralin” kena pasë mrri suksese të mëdhaja. E para shfaqje domethonë kur kena fillue ka qenë “Familja e Peshkatarit”, sefte, Nuhi Matoshi ka qenë një regjisor për fëmi në Radio Televizionin e Prishtinës gjatë, ai u konë, Sabedin Shahiqi, Osman Bunjaku {numron me gishtat e dorës}, u konë ni... Dini i Orllatit, profesor ka qenë i gjuhës këtu në Gilan, edhe ai ka pasë marrë pjesë, pastaj Jahi Jahiu osht’ një skenarist i cili e ka krye në Beograd.

Shfaqjen e parë, domethonë, une edhe s’pe di sa jena konën, nuk po më kujtohet krejt tash edhe {çon duartë lartë në shenjë harrese} kohë e gjatë, veç kryesore po më thirrë qiky Hasan Bunjaki edhe po më thotë, “Bajram a po vjen p’e formojmë teatrin, a po vjen me lujtë nifarë shfaqje?” Une s’e kom ni vetën si artist {tundë kokën në shenjë mohimi}. Isha me thonë i dhanun në tjera, këto farë tjerat edhe sun, s’jom asih... mirëpo, për shkak të shoqnisë, se krejt jemi konë të njoftun nërmjet veti doemthonë, për shkak të shoqnisë atëhere ja nisa me u aktivizu atu në teatër. Edhe mo qashtu dikun dymdhetë vjet ka vazhdu ajo.

Anita Susuri: Sa po i bjen që keni qenë?

Bajram Zymeri: Po prej 20 vjete e deri në 32 vjet qashtu.

Anita Susuri: Dhe pastaj keni kalu në ndërmarrje?

Bajram Zymeri: Në ndërmarrje kom qenë unë prej ‘76-ës.

Anita Susuri: Aha, kjo veç vullnetarisht?

Bajram Zymeri: Kha, na veç vullnetarisht, na mas, mas orarit të punës, çdo aktivitet vullnetar që u konë ajo osht’ punë mas orarit të punës. Edhe na në mbramje ma tepër në teatër kena punue, ditën ma pak u punu. Ditën, për shembull veç kur osht’ mësu teksti, për shembull aktortë asi, tana në mramje aty.

Anita Susuri: Edhe shfaqjet në mbramje?

Bajram Zymeri: Edhe shfaqja në mbramje ipet edhe krejt ato, nuk ka pasën tjetër sen, nuk... ma tepër që ishmi bashkë, e kalojshmi kohën bashkë me shoqni ishte diçka ma e madhe se çdo gja. E kalojshmi kohën, se edhe s’ke pasë tjera aktivitete në atë kohë.

Anita Susuri: Po, ju më tregutë për kamerat, që keni pasë gjithmonë edhe jeni marrë me zhvillimin amatere, me fotografim, edhe më tregutë për një rrëfim për televizorin e parë që ka ardhë edhe e keni shiku krejt.

Bajram Zymeri: Ajo ka qenë në 1960-ën, Rinia e Teknikës Popullore, se në atë kohë jonë organizue Brigadat Vullnetare Punuese⁹ nëpër Jugosllavi. Edhe na si Teknikë Popullore, kohën e lirë mas punës ata që e bojnë, për shembull ka qenë, “Shah-mat Sarajeva” ajo u konën, në Bujanovc, në Nish rruga, e krejt ato jonë në atë kohë, vullnetarisht jonë nisë me u marue. E tash ka pasë brigada punuse peç çdo veni, e me brigadën punuse të Gjilanit, ka shku edhe të ritë e Teknikës Popullore atje me i mësue me boe fotografi edhe radio-teknikë, me i mësue me fotografu, edhe me... domethonë, ata masi ta kryjnë punën fizike nëpër asi, si argëtim me i eduku, me i mësue edhe e marrshmi do farë diploma ja u bojshmi, si fotografist ose si asi.

E domethonën, Gjilani ka qenë si një ma e mira në ato aktivitetet e lira që i kanë pasë aty brigada. Edhe për ato që jemi kanë një ndër ma të mirtë, ata na i dhurunë ni televizor, emnin e ka pasë televizori “Orion”, si sot më kujtohet, ka qenë dikun 61 centimetra. Edhe kur e prunën në fillim nuk ka pasë programe se s’kishke releja¹⁰ afër, u mundojshmi edhe i zishmi [kanalet televizive] italiantë. Interesant në atë kohë, lyp, lyp, lyp, e gjojshmi italian deri sa u rregullu ni rele. Eh, masi u rregullu në ‘61-shin, atëhere mujshmi me përcjellë programe.

E tash kur u lujsin ndeshje kështu, aty në... se ka qenë salla mrena në Teknikën Popullore ku ka qenë televizori, beso që bon vaki 50 vetë u mbledhshin me kqyrë kur dilshin me kqyrë. E kur kishke, për shembull loja të Jugosllavisë apo ndërkombëtare naj lojë, ka qenë ballkoni i ndërtesës të Teknikës e qitshmi televizorin në ballkon edhe ku osht’ tash posta e qytetit. Edhe ai veni në mbramje u bojke vashar¹¹, s’ka pasë televizor kërkush në Gilan në atë kohë, edhe e kqyrshin ndeshjen. U kanë si senzacion në atë kohë. Ajo ka qenë viti ‘60.

Anita Susuri: E për fotografim, qysh i keni zhvillu fotografitë, a keni pasë vend në shpi?

Bajram Zymeri: Jo, jo, jo, une edhe në shpi kom punue po edhe aty e kemi pasë ma së pari i thojnë komorë¹² asaj dhomës ku pregaditën filmat.

Anita Susuri: Dhoma e errët.

⁹ Brigadat Vullnetare Punuese janë organizuar dhe mbikëqyrur në nivel lokal, të republikës dhe federatës nga Lidhja Socialiste e Rinisë së Jugosllavisë. Akcionet punuese angazhoheshin në ndërtimin e infrastrukturës publike, siç janë rrugët, hekurudhat dhe ndërtesat publike, dhe po ashtu përfshiheshin në ndërtimin e infrastrukturës industriale. Këto akcione punuese janë organizuar nga vitit 1946 deri në shpërbërjen e Jugosllavisë në vitin 1990.

¹⁰ Në kontekstin e televizionit me sistemin me antenë apo kabllor, releja (Ang.: *relays*) i referohet pikave të distribuimit të valëve apo objektit që bën pranimin e signalit televiziv nga burimi dhe më pas bën amplifikimin, procesimin, dhe ritransmetimin e atyre signaleve tek ndjekësit televiziv që kanë atë lloj antene, sistem kabllor apo rrjet televiziv.

¹¹ Srb.: *vašar*, ka kuptimin e panairit që është një formë e tubimit publik. Qëllimi kryesor i vasharit apo panairit ishte që fshatarët të blinin gjërat e nevojshme në një kohë kur nuk kishte dyqane në kuptimin e sotëm.

¹² Srb.: *komora*, dhoma e errët ku zhvillohen fotografitë në film.

Bajram Zymeri: Dhoma e errët. Edhe se në Teknikë kanë qenë të ndame, Radio Teknikës ka qenë, se ka pasë dhoma mjaft aty në ndërtesë edhe e filmit e ka pasë komorën, e ka pasë vendin për shembull ku kemi boe fotografi, edhe aty u pregaditke masi u kryjke filmi, u lajke domethonë niherë me zhvillusë, tanaj me fiksir, edhe e kemi pasë asihë... Ni kohë e kom pasë organizue maturantat me i fotografu, i kom fotografu dikun njo... une ata privat kështu vet e përdorsha atë komorën e Teknikës, ama me material temin i kom pasë fotografu maturantat edhe e pregaditsha atë tabelën. Se në Gjilan, nuk e di në tjera vene a jo, amo në Gjilan u bojke tabela e madhe {përshkruan madhësinë me dorë} fotografitë e secillit nshanës maturant, profesorat, një ose dy tre profesora. Edhe i qitshmi në qytet nëpër shitore, për shembull në vitrina jashtë që njerëzit m'i pa maturantat të cilët jonë në kit vit.

E nja dy vjet i kom pasë marue une ato, tanaj e fotografojshmi atë panonë me fotografi, secili nshanës i marrke gjashtë fotografi kështu të vetat {përshkruan fotografitë e vogla} edhe njo të madhe të asaj kompletit {përshkruan me duar kornizën e fotografisë të madhe}. Ka qenë një shkollë teknike, një nshanës ni maturant e kish ni lyth të zi qitu {prekë hundën}, e tash ai ish konë i kompleksumë, tip i kompleksumë, ku e di une. E tash nuk mujsha me ja mshefë lythin, ai edhe këmbëngulke diqysh. A krejt gati dalshin drejtë, bre ja ndrojsja pozitën bre, i kom bo përmi 15 fotografi e s'i përleqjke. Dikur niherë tha, "Hiç mos e merrni fotografinë tem", ajo s'ishke se kumeditë se çka problem, e ka natyrale {prekë hundën} po ishte i kompleksumë pse e ka, asi... e dikur na menxi ni pozitë {kthehet nga ana e profilit} edhe u konë bajagi e madhe [lythi], a din, kështu që shumë fshtirë ishte me e mshefë. E e patëm asih... është si rast kështu karakteristik.

Anita Susuri: E si amater, për shembull që keni bo fotografim, çka keni pasë ju qef ma shumë me fotografu?

Bajram Zymeri: Une i kom deshtën ma së shumti fëmiteme i fotografue, se osht' fotografija ma e mirë bohët e fëmive. Interesant osht' fëmija të kënaqë. I kom pasë edhe sidomos në Stamboll atje kom pasë çka me fotografu, me xhamija, i gjojsha kandet, kom pasë qef. Për shembull, ma tepër... e kom pasë majtë ni ekspozitë nihere kështu në Gjilan, për shembull, kubizmi, ma tepër si kubizmi kom pasë qef kandet të ndryshme me i asihë [theksu], ato i kom adhuru shumë. A fëmija ka qenë diçka e paimagjinushme, se shumë osht', nuk... që ta, kur dojsh me ndreqë me fotografu dikun a din, kurrë nuk del natyrore, osht' diçka jashtëzakonisht ideale. E ato i kom adhuru ma shumë.

[Këtu ndërprehet video-intervista]

Anita Susuri: Në vitet e '90-ta që keni punu në Teknikën, në këto ndërmarrjen...

Bajram Zymeri: Po, deri... po.

Anita Susuri: A ju kujtohën juve këto ngjarjet, për shembull që kanë ndodhë prej '81-tës që ka fillu me demonstrata?

Bajram Zymeri: {Tundë kokën në shenjë mohimi} Kam qenë... s'kom qenë këtu, shumë keq. Për shembull në '81-tën kom qenë në ushtrinë ushtarake në Nish, kom qëllu sss.... Mirëpo, ka qenë edhe ni problem tjetër, demonstrusit s'kanë pasë dëshirë m'i fotografu, ajo gabim i madh për shembull, mirëpo edhe nuk u konë gabim se nëse ti ke fotografue, atëhere të kishin konsideru si shpijun. S'e di a po më kupton?

Anita Susuri: Po, po, po. A i ka përcjellë policia ata që kanë fotografu?

Bajram Zymeri: More, të ka detyru policia me ja dhanë ti fotografitë, kështu që tu e pa... se ju nuk e dini, kur je familje e përndjekun, se na e kemi pasë vëllaun, ju nuk e dini çfarë vëzhgime na kanë boe, na kanë asih, diçka osht' e paimagjinushme, veç ata që e kanë përjetu e dinë. Kështu që, une ju kom ikë atyne gjanave, për shembull, veç me ardhë e me ta lypë policia ti e hupshe atë reputacionin që e kie, kështu që na i kemi ikën asaj. Teknika Popullore edhe Komiteti Komunal i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë aty në Gjilan kanë qenë ngjit njona me tjetrën ngat-a-ngat. Bile, jonë frigu mos po xhironjë a mos po fotografojnë prej Teknikës dikush, mirëpo ato s'ka leju vëllau i madh, ato s'ka leju, po thom se ka pasë ni tjetër konotacion, i kemi ikë asaj.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Çfarë date ka qenë kur ju kanë largu prej punës edhe qysh ka ndodhë?

Bajram Zymeri: Po fillunë ato problemet mo, erdhën organi mbikqyrës krejt sërbitë e murrën në çdo asi [instancë]. Kemi qenë dikun 500 punëtorë në ndërmarrjen tregtare edhe me 7 shtator [1990], na e bojkutumë edhe e majtëm ni ditë mbyllë krejt shitoret, vetëm tre shqiptarë jonë sodilarizu me ndërmarrjen, tjetër krejt i kanë mbyllë shitoret, kërkush na demonstrativisht i patëm asihë [mbyllë]. Bile, ni shqiptar ka qenë si kontrollë interne na i kish pasë mshelë krejt ka ni dry në dyqan, se une isha në dyqan, në atë shitorën e specializume edhe thanë, "Kena me ju boe regjistrim". "Po bone regjistrim, punë e madhe". Edhe na fillumë atë rezistencën, për shembull me asihë, kush ishte në Lidhjen Komuniste i dorëzunë librezat e partisë e krejt. Se unë i kom pasë dy referenta, një shqiptar edhe një sërbi, ai sërbi e ka folë shqipën bylbyl, me ta kom udhëtu për shembull në Beograd, Zagreb, Nish, në Lublanë, gjithmonë.

Edhe kur shkojsa në mëngjes une me u konsultu për mall apo diçka, qiky sërbi që e dijkë shqipën, ma përpara ngajke me ma maru kafën, se ai shqiptari edhe pse atë shqiptarin e kisha shok, domethonë qashtu ka qenë ai, shumë... mos me besu që ai mun me konën qaq nacionalist, qai sërbi. Si u bo krejt qikjo, ai ndryshoi krejt komplet, u bo arrogant, u bo... krejt ata që kanë shku mirë me shqiptartë, ata u bonën mas agresivi, mirëpo edhe na u bonëm agresivë. E dikun përnihere 200 punëtorë i largunë si

tepricë teknologjike edhe pesë [prej] neve na largunë me vendim kështu. Atyre me tepricë teknologjike ju jepshin kah 50 përqind rrogë, s'e di sa muj, gjashtë muj më dokët. A neve na i ndërprejtën marrëdhaniën e punës pesë vetëve.

Anita Susuri: E me çfarë arsytimi?

Bajram Zymeri: Arsytimi pesë ditë nuk je konë në punë. Kjo osht' shumë ni pyetje me vend, se do t'i tregoj shumë osht' interesant. Nji prej pesë ditëve ka qenën e dille, të dillen nuk punohët, ata nuk i kanë kqyrë ditët po veç datat i kanë shkruë edhe më largunë prej punës në dhjetor të '91-shit. Kur p'e lexoj une vendimin, p'e shoh ni ditë e dille. Une i kisha ato krejt, se une i dorëzova ato krejt, se une e dorëzova zyrtarisht dyqanin, se m'u dashtë me dorëzu se ma mbyllën. Për katër ditë tjera, domethonë kisha mbulesë që s'jonë qashtu. Për shembull, se aty më ka shkruë, "Nuk ka qenë në punë hiç fare pesë ditë", ni ditë e dillë, të dillën nuk shkohët në punë, për këto katër ditë kisha mbulesa për shembull, kom dhonë mall me virman i thojnë, jonë me faktura që paguhët nëpërmjet bankës, u dashke me ja bo profakturën. Kisha une dokument, domethonë me dokument une e dokumentojsha që ato katër ditë jom konë në punë. Plus kom dorëzu pare, kom... kisha, krejt ishin në favor temin.

Shkova, po i thom kryetarit të sindikatës thashë, "Qishtu qishtu, më kanë largu prej punës", edhe thashë, "do t'i paditi në gjygj". "Leje more", tha, "mos ja nxirr bishtin", tha, "ai të ka qit' prej punës, ti p'e paditë". Une thashë, "P'e paditi, krejt jonë dëshmitë në anën teme". Nantë vjet jom shty në gjygj me ta, tri herë Beogradi e ka pru në favor të temin, tri herë këta, se drejtori jem edhe kryetari i gjygjit ishin sërbë edhe më njifshin, këta e bijshin vendimin kundra meje. Dikun në mars [1999], pa fillu bombardimet e [NATO-s] kemi majtë seancën e fundit gjygjësore, se gjithmonë majshim seanca gjygjësore, se krejt çdo gja ishte në favor të temin. Nantë vjet jom shty me ta në gjygj. Edhe para bombardimeve e kemi majtë seancën e fundit edhe tanaj fillunë bombardimet.

U shlirimë mas tre mujëve, une shkova, se gjygj si gjygj ai njajtë ishte si... edhe shkova une gjygjit i bona kërkesë me vazhdu me ni ren aty ku ka metë senaca gjygjësore, mirëpo tash veç ishin gjykatësit shqiptarë. Edhe une e fitova atë gjykim, edhe tanaj më kanë dëmtu valla për nantë vjet shumë pak pare më kanë dhonën, për... merre me men këta shqiptarët tash që ishin në organizatë, këta dulën ma sërbë se ata sërbitë, jo s'dojshin me m'i dhonë paret. Thojshin, "S'të kena largu na", "Po, o ti njeri, ti s'më ke largue, une s'e kom paditën as Mitën as Ismetin, une ndërmarrjen e kom paditë. Une kom punë me ndërmarrjen, jo me person". E s'dojke drejtori me m'i dhonë paret. Plus atë ekspertin që e cakton domshpërblimin, për shembull, e kishke shok ky drejtori shqiptar edhe dikun për dhetë mijë euro më ka dëmtu. Nuk e disha arsyjen pse, vetëm pse isha une rugovist, e ata ishin tjerë parti. Saqë nihere u pata... se une tash kur u ktheva, une nuk u ktheva mo në shitore, po u ktheva si inspektor i ndërmarrjes.

Anita Susuri: Pas luftës?

Bajram Zymeri: Po, pas luftës jom kthye tana në ndërmarrje. Edhe ka pasë shkue gjorollti për ato, mirëpo në fund i kom marrën dikun 24 mijë euro domshpërblim, po, po. Ti merre me men, ai eksperti për ni vjet asni cent s'ma ka caktue domshpërblim, "Jo, ka pasë inflacion dinari me markë", mu s'më intereson çka ka pasë inflacion a s'ka pasë, kryesore me qatë rrogë u pagu rryma, u pagu uji, u pagu bërlllogi, u pague, o ble sheqeri, o ble milli, ti... se osht' e vërtetë që ka pasë inflacion, amo ti duhësh me llogaritë me ni rrogë çka munësh me ble, me asih.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu angazhimi juj mas largimit prej punës?

Bajram Zymeri: Une ja u kom pa hajrin atynve serviserave që më vijshin në shitore, se e perfeksionova riparimin e televizorave, shporetave, lavatriqeve, sidomos për lavatriqe kam qenë ekspert i vetëm në atë kohë në të '90-tave në Gilan. Bile i pari ja kom nisë ato elektronikën që dulën do farë, i bishin do farë makina pej Gjermanisë të përdorta, a din, e kanë pasë elektronikë, ja kom nisë me i riparu apet, domethonë këta tjetër elektrikën e asihshin, ama elektronikën s'kanë ditë edhe s'kanë mujtë. E ato e kom, se fëminë i kom pasë shumë të vogël në viteve të '90-a, domethonë isha vet i gjashti, u dashke me majtë diqysh familjën, pata marue asi kartela reklamuse {përshkruan formën e tyre}, veç i shpërndajsha i asihsha. Mirëpo, më kanë njoftë qytetarët e Gjilanit shumë, e kanë ditë aftësitë e mija, une s'kom pasë nevojë me çelë dyqan hiç, mu veç më cingrojke telefoni, "Hajde m'u ka prishë qikjo, m'u ka prishë qikjo, m'u ka prishë qikjo", edhe deri në çlirim qajo më ka majtë, qajo. Kom punue, zanatin e kom punue.

Anita Susuri: Jeni marrë edhe me fotografi?

Bajram Zymeri: Ja, ja, ja, vetëm me riparimin e këtyne aparateve shtëpiake, s'më ka interesue në atë kohë fort fotografia. Dikujt, u konë... eh naj darsëm po, kom inçizue me kamerë, a edhe ato familjarisht, jo kështu të hujtë. Edhe kanë ardhën deri në çlirim une kom punue, kom servisie, kur filloi mo lufta isha në shpi qitu kemi qenë, nuk kom dalë prej këtuhit. I kisha dy vëllaznitë e sëmutë, te dytë prej zemrës, s'kishmi ku shkojshmi. Çka osht' ma e keqja pasosh s'kena pasë. Nuk dojsha, pa krisë lufta nuk kom deshtë me marrë pasoshin, thojsha veç pse atmosfera ishke që na mo veç po shlirohmi, pa kërshitë lufta, qashtu ka qenë atmosfera. Thojsha une, "Pasoshin e Republikës të Kosovës veç kom me nxerrë tash e tutje", më patë dalë mu afati i pasoshit.

Mirëpo, gjatë luftës kom vujtë shumë, se thojsha fëmija nuk më kanë faj për budallakinë tem, se në fillim veç me pasosha majshe me dalë jashta Kosovës. Tjetër o kur i kapshin i përmbledhshin për shembull për Shkup e anejna, ama nja disa muj ke mujtë me ikë me pasosh, me dalë jashta. E une tash ja nisa, se une për veti s'e kom pasë njet me dalën, por thojsha fëminë i kisha qitë, veç fëmija të më kishin... saqë ni natë jom konë shumë në gjendje të keqe thojsha, "Këta nuk më kanë faj për budallakinë tem që s'ja u kom nxjerrë pasoshat". E dojsha pasoshin e Republikës të Kosovës, a qitash mujnë me na likfidu në çdo moment.

Anita Susuri: Qysh ka qenë gjendja në Gilan?

Bajram Zymeri: Në Gjilan ka qenë e qetë, po muj me të thonë që relativisht e qetë. Edhe pse, une e kom pasë ni telefon, ni aparat, i cili i ka pasë dymdhetë kanalla. Une kom mujtë me ndëgju bisedat, domethonë të sërbeve, me telefona ajrorë të tynve. Domethonë, nëse kanë bisedu dikush me telefona ajrorë une kom mujtë me i ndigju. Domethonë, s’kom pasë problem, varësisht në cilin kanall hisha edhe dikon e gjojsa. Mirëpo, unë s’e disha kush o tu folën a din, veç kur përmeneke naj emër. Une e di, për shembull kur u bo ni masakër në qendër, amo të sërbeve, të paramilitarëve me këta të vetët. Nërmjet veti jonë vra, te teatri jonë vra.

Anita Susuri: Pse ashtu?

Bajram Zymeri: Kumeditë jonë rrokë, jonë pijavë, jonë asishë, sërbe mo. E di kur ka ra ni natë shi i madh edhe në podrum i kanë pasë municionin, edhe ja u ka marrë uji, ata e kom ni. Ose i ndëgjojsa kur jepshin raport nërmjet veti ushtria me asi, i ndigjojsa. Edhe ndigjojsa thojshin, “Sot do t’i bijnë qisaj lagjes”, mosvet, “Gavranit do t’i bijmë”, u tmerrojsha kur i ndëgjojsa ato gjana. Bile, nihere nja dy javë s’i kom ndëgju hiç, se çka s’ndëgjojsa në atë... bisedat e tyne. Me thonën dy gjana i kom ni pozitive në ato dëgjime që i kom bo une gjatë luftës {ngritë dy gishtat e dorës lartë}. P’e thirrë ni sërbe sërbin, a din, edhe po i thotë, “I kena qit’ banortë e fshatit të Cërnicsës”, p’i kallxon. Ky p’i thotë, “Eh”, tha, “Sërgjani”, tha, “ka kajtë kur i kanë qit”, paska kajtë ni Sërgjan i Cërnicsës ju kanë dhimtë shqiptartë që i kanë qitë. Ky tash po ja kthen, “Pse s’e keni vra?” Tha, “Sërgjanin bashkë me shqiptartë”, p’i bërtet a din, “U konë dashtë me vra edhe Sërgjanin”. Domethonë, e kom ndi ni diçka pozitive që ni Sërgjan koka konë që ju kanë dhimtë shqiptartë.

Edhe ni rast u konë, dy femna bisedojshin, e di njo u konë e anës të Novobërdës njona, edhe në bisedë të sipërme p’i thotë, “Kom metë pa vaj”, ajo e Novobërdës, kjo p’i thotë, “Qysh more me metë pa vaj? A e din që na krejt dyqanet e shqiptarëve ja u kemi plaçkitë, ja u kemi marrë vajin e ti pse me metë pa vaj?” P’i thotë kjo e Gilanit, ajo i tha ksajna, tha, “Me shati”, tha, “kom m’u ushqye”, tha, “të hujën s’e du”. Qajo domethonë, paska najnjo me ndërgjegje, po qato dyja i kom ni ashtu. Edhe kur kanë shkue se qikah jonë konë ushtria e vendostë, atë natë kur kanë shku krejt i kom pa. Në ballkon jom shtrie, po nuk mujsha me i... terr shumë s’mujsa m’i fototgrafue, më ka metë marak. I pahsha, se edhe ata s’i kallshin dritat, krejt do drita kështu po get me...

Anita Susuri: Të automjeteve.

Bajram Zymeri: Të automjeteve, ama kësi drita që jonë me rreze a kumeditë une, raketat e gata, krejt qitu kanë kapërcy, në qit rrugën qitu. Eh, kanë ra, kjo bile u shashtriske kur bojshin bombardime qikjo Malisa kanihere, i kom pasë të vocërr fëminë. Ka ra ni bombë te Fakulteti i Edukimit, prej qituhit i ka nja 200 metra, e veç kur o dridhë shpija. Jemi konë në ballkon qishtu, veç kur e kemi ni ty ra dhe përmi çeremide e kështu a din. Fati ka deshtë që nuk ka kërstitë ajo bombë. Kish pas hi deri në gjystë në tokë,

në oborr të Fakultetit të Edukimit, qitu s'i ka as 150 metra. Fati ka deshtë. E kur hinën trupat e hujë e kum bo ni fotografi e kom boe tu e nxerrë atë bombën prej atyhit.

Anita Susuri: E në shpi a ju kanë ardhë?

Bajram Zymeri: Na kanë ardhë ni herë veç. Erdhën me i regjistruë policia, une vëllavin e kisha në dhomë naltë ratë në dhomë se ishke post-operacionit, ai tjetri anejna, e këtu isha tu lujtë me atë djalin e vëllaut shah kur erdhën dy policë. I murrën, naj lypën letrat e letërnjoftimit, na regjistrunë, na i dhanë do kartona. Nuk hypën naltë, interesant, jo hypën deri në dhomë të vëllait, se i kallxova që vëllain e kom të sëmutë. Edhe po, jemi shku te vëllavi e kanë pa ratë, ni çikë e vllavit këtu u konë tu i la entë bile p'i thotë, "Kthehu me ta pa ftyrën", i bërtiti. Ata hinën qitu me këpucë me krejt dy policë asi. Na i murrën shënimet, na i dhanë ka ni karton. Në atë kohë, na supozojshim për çka qysh tek, e krejt qytetin e regjistrunë.

Anita Susuri: E kartoni çfarë përmbajtje ka pasë?

Bajram Zymeri: Kurgjo, emrin, mbiemnin, ditëlindjen, krejt qato, qato i ka pasë. Bile e kom pasë ni qasi kartoni naltë nuk e di ku mun me konën. Në çdo shpi kanë hi, në çdo shpi ren, pa dallim. Nihere, se në mbramje une e kom pasë Reno 4-shin, edhe kur hishmi mrena me fjetë une shkojsha e pshtetsha se dyrtë e hekrit i ke pa qysh jonë jashtë [i drejtohet intervistuesës], e pshtetsha Renojën te dyrtë kështu, e çelsha derën dalsha në anë të djathtë isha mrena që me pengue Renoja mos me mujtë me hi. Thojsha, budallakina, a din se i pata maru hekrat mrena këtu. Po ai ni bombë ta lëshojke ti... po, a din qe, une thojsha në hezin e parë që nashti me pshtu qitu me kcy anejna përmas me dalë e asi, bojshmi do farë asi. Osht' interesant se kishmi frikë të madhe, na çelke mëngjesi, nuk e dishmi qysh po na mshelë mramja. E mriishmi mramjën, s'e diishmi qysh po na çelë mëngjesi.

Mirëpo, interesant, e ni ditë m'i kanë shpërthy me bajonetë rrotat e Renojës se para derës e majsha, e kur m'i, veç ka ardhën ni kojshi tha, "O axha Bajram", tha, "t'i shpërthynë gumat me bajonetë". S'kishe çka me bo, s'ki çka bon veç rrishe qaty te shpija ishalla veç nuk të asihin. Ni dite thashë kom me riparu maqina të lajmes edhe gjatë luftës. Më thirrshin, i hypsha bicikletës shkojsha, ku më thirrke shkojsha. Edhe ni ditë, une isha në kojshi qatje kur po më thojnë, po më thirrin, "Hajde se po të thirrë ni sërë", bile tha, "polic osht'", u frigova vallahin po të thom të drejtën. Jom ardhën, ai ish konë në trenerka, "Mirëdita!" "Mirëdita!" edhe une. "A ki", tha, "dikon në Prishtinë?" Une motrën e kom pasë në Prishtinë po e disha që osht' në Maqedoni, kanë pasë dalën. Thashë, "E kom edhe balldëskën", se motra e shoqes ishte në Prishtinë, të vetmit të shoqës tem, shoqja jem edhe qajo balldëska në Prishtinë kemi nejtë në Kosovë.

Tjertë krejt patën shkue në Turqi, veç na kishim pasë nejtë. Edhe ajo balldëska e ka pasë burrin milic para luftës, thojsha mos... mirëpo, patën metë, ata në Prishtinë edhe na këtu. Komunikim s'kishmi kërkush, shkojke ni muj e gjysë e tepër, kurrëfarë komunikimi. "A ki", tha, "dikon në Prishtinë?"

“Vallahi”, thashë, “e kom motrën po osht’ në Maqedoni” “Tjetër kon a ki?” Nihere harrova une krejt edhe më ra në menë thashë, “E kom balldëskën”. “Ku e ki?” Po i kallxoj i thashë, qishtu qishtu. Une e dita që diçka po dijnë, a din. Edhe tha, “Më ka çue balldëska jote, se une jom polic po shërbej”, tha, “në Prishtinë”, e kojshika e qitij policit sërë ish konë kojshi me kit balldëskën tem. E tash ajo paska qëllu balldëska me atë kojshikën e vet kur ish konë ky aty, edhe informata a din qysh jonë në Gilan për atë kojshikën, se ajo e Gilanit ish konë qajo kojshikja. E tash, i kanë thonë me vetën për neve, a jemi mirë, a s’jemi, a qysh jemi, se pa kurrëfarë kontakti. E ish ardhë m’u interesu tash ky polici për atë balldëskën.

Edhe po më kallxon ai polici, “Qishtu qishtu” “Ouuu {onomatope}”, thashë, “po bre e kom balldëskë anej knej... veç më ka çu me vetë, ‘A jeni mirë a qysh jeni a tek jeni’”. Thashë, “Thuj mirë jena”, po thashë, “a bon ni minut me pritë?” Edhe jom hi mrena, e kom marrë ni paqetë cigare Bozhur, e kom pre me skallper kështu atë cellofonin që osht’ i hollë, e kom marrë ni fletë, edhe i kom shkru njo pesë gjashtë fjalë. I kom thonë, “Kadri, na jemi mirë komplet, shpresoj”, thashë, “që edhe ju të jeni mirë”, edhe e kom shti që me lexue ata çka osht’ e shkrome, a din, e kom shti në atë farë asi, thashë, “A bon qit paqetë cigare me ja çu masi paske kontakt me atë kojshikën e balldëskës”, thashë, “veç me i përshëndetë edhe me ja u çu qit paqetë cigare”. Ja kish pasë çu.

Anita Susuri: E ju do të thotë keni udhëtu me bicikletë.

Bajram Zymeri: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë gjendja?

Bajram Zymeri: Hiç s’ka pasë, u majke. Na i thojmë Mahalla e Romëve, prej qituhit i ka nja dhetë minuta në kamë me shkue, aty u bojke pazar. Magjuptë¹³ kanë qenë krejt me sërë, romtë, ata jonë konën. Edhe ata shkojshin në Bujanovc marrshin mall, bishin, u majke pazari aty, shkojshmi blejshmi asi, edhe ja nisën me shkue edhe qytetartë e këtuhit shkojshin në Bujanovc edhe u kthejshin. Ni ditë shoqja jem me ni shoqe të vete kojshi edhe me ni çikë të vllavit, “A po shkojmë edhe na në Bujanovc”, me kontakti me telefon me, se këtu s’kishmi mundësi me bo telefonata, “me shku në Bujanovc me folë me telefon me”, shoqja jem me prindët, me ata që i kishte jashtë. Vjehri i asaj shoqës të grujës ai tha, “Jo, une s’ju lo me shku vetë”, ai ishke i vjetër. Tha, “Po vi une me juve”. Edhe i kanë hypë autobusit edhe jonë nisë, jonë shku për Bujanovc. Kur kanë mrrie te Konçuli më dokët, a te Bujanovci nuk e di, veç kryesorja i kanë nalë edhe i kanë kthy, s’i kanë lanë me shkue.

E jonë nalën në Konçul, e kanë pritë gjithë ditën deri sa të kthehet autobusi edhe s’kanë bo kurgjo hiç, s’kanë shku. “Po pse bre gru”, thashë, “po shkon”, thashë, “çka?” “Jo, jemi bo marak për nonën e babën e vëllain e...” mas dy dite apet kanë shku. E herën e dytë kanë shku në Bujanovc, kanë bisedue me fëmitë e vëllavit tem, me... shoqja me babë, e nanë, e vëlla, e motrat se i ka pasë edhe do motra atje, krejt jonë konë në Turqi. Ka bisedu gjatë luftës, domethonë qatëhere, ka bisedu, ka asihë, ju ka

¹³ Term derogativ për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

tregu që jemi mirë. Edhe te knejna kishin pasë ble tlynë e sheqer e qisi gjona, kishin pasë marrun diçka, diçka, edhe jonë ardhë te shpija. Kanë bujtë ni natë aty, në Bujanovc, të nesrit jonë kthye kishin marrë diçka, diçka, edhe jonë kthye, se përndryshe po thom në qytet nuk ke mujtë me, veç kur kërshitshin bombat, atëhere ishke pak e trazume.

Përditë qitu kalojshin me automatik ushtria, se thashë naltë e kanë pasë bazën, a kështu përveç qatëherë që m'i kanë shpërthy gumat, s'më... në Gilan jonë vra dikun shtatë vetë, ni gru tuj ardhë prej fshatit Malishevë në rrugë ka ndodhë e kanë vra, ditën e parë të bombardimeve mas spitalit kishin dalë njerëz në dyrë, a din, me brohoritë që fillunë shqiptartë, a din, bombardimet, e i kish pasë gjujtë dikush me snajper ni femën në derë të shpisë, ish konë dalën me asihë. Te Bregu i Përshit, osht' te vorret qatje, aty ni granatë edhe aty u vra ni Ramadan e ka pasë emrin, futbolleri i Gjilanit, edhe ai u vra aty. Kështu hajkë¹⁴ domethonë me asihë nëpër shpija me asi, nuk ka pasë, nuk ka pasë, në Gilan po foli, vetëm për qytet. A në fshatin, këtë... qy më dul prej [mendjes], te Zhegra osht', aty kanë bo masakër, aty thojnë edhe kanë dhunu edhe kanë vra edhe i kanë djegën. Nuk e di saktësisht sa njerëz i kanë asi, por në atë fshat, se u konë ngjiti fshati me ni fshat sërb, e aty kanë bo masakër.

Anita Susuri: Mas luftës ju thatë që jeni angazhu prapë në punë, po qysh ka ndodhë krejt ky adaptimi?

Bajram Zymeri: Nuk ka pasën naj, se për shembull e ke pritën domethonë kur jemi çlirue. Une po foli personalisht për veti qysh jom ndie, edhe familjarisht normal ka qenë gëzimi i parë, bile e kom ni fotografi me ato çikat kur kanë ardhën, se trupat franceze kanë hi sefte këtu. Bile qitu njo 200 metra kanë shkue qikjo Malisa, Ditika, Fatimja, edhe s'e di cilla, jonë shku lula ju kanë dhonën. E kom atë fotografi, lula ju kanë dhonën ushtarëve francezë, ka qenë gëzim i paharrushëm. E kom shku me ni ren te shpija e vëllaut, ajo ka qenë në mes të sërbeve atje, a tanaj [na] ishin azgon [trima] masi hinën trupat e hujë. Ja kishin marrë antenën satelitore ni kojshie, do gjana a din, edhe i zateta po ju thom, "Mrena pesë orëve me i kthye", edhe i kanë kthye.

Aty kanë qenë, se në fillim patën nejtë, qitash mo s'osht' kërkush, amo në fillim patën qëndru aty, e të nesrit tanaj u bo ai manifestimi këtu në Gilan, dulën brohoritje, jo ushtartë ata u veshën plot që s'jonë konë, jonë konë, ka pasën edhe që s'jonë konën as ushtarë as kurgjo, ja nisën me veshë edhe uniformë me asihë e me, po neve s'na interesojke ajo hiç. Na dulëm e kqyrëm atë manifestim që u bo, kishke brohoritje, kishke asi. E na mas luftës familja komplet jena tërhjekun politikisht.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Në cilin vit jeni dalë në pension?

Bajram Zymeri: Shtatë vjet, sa p'i bjen tash 2023, 2016-ën po.

¹⁴ Srb.: *hajka*, në përkthim ka kuptimin ndjekje, përndjekje.

Anita Susuri: Para gjashtë viteve.

Bajram Zymeri: Para gjashtë viteve po kom dalë në penzion.

Anita Susuri: Deri në penzion keni punu në ndërmarrje apo?

Bajram Zymeri: Jo, jo, jo. Në ndërmarrje kena punue veç tri vjet e gjysë, katër, me ni ren mas luftës ma kanë dhonë ni vetshërbim me udhëheqë, dy vjet e kom udhëheqë në 2002-tën, 2003-tën. Tana, e mshelëm atë vetshërbimin, nuk kishte shumë punë se në atë ven ishke qashtu. Tanaj më caktunë mu inspektor, tanaj kom punu në zyre të ndërmarrjës edhe filloi faza e privatizimit. Edhe pas ni kohe të shkurtë, njo gjysë vjeti veç AKP-ja na i mbylli librezat e punës edhe secili në shpi të vetë. E tana kena nga për atë 20 përqindëshin, qitu na ka ardhë {prekë majën e hundës}. Mirëpo, osht' interesant që ndërmarrja jonë, punëtortë kanë marrë gati ma së shumti pare prej privatizimit, se ka pasë shumë, veç shitore sa ka pasë, dy shpija të mallnave, shumë dikun gati ka tetë mijë, nandë mijë euro çdo punëtor i ka marrën prej 20 përqindëshit. E une plus tanaj i kom marrë edhe ato çka më kanë, çka i kom fitu me gjygj, edhe ashtu ka qenën. Jom marrë me zanat, deri sa fillova mos me mujtë mo, deri në pension gati. Mas pensionit filloi edhe ashtu e kanë parapa 65 vjet me dalë në pension se mo veç nuk je për punë, nuk je për. E mirëpo jom i kënaqun me, jom konën nihere edhe në festë te Besim Dina.

[Këtu ndërprehet video-intervista]

Bajram Zymeri: Mas luftës i kom njekë shumë këto nëpër televizion, për shembull fjalëkryqet e këto. Jom konën anëtarë i rregullt i tyne edhe i kom marrë përmi 50 shpërblime i kom fitu nëpër këto farë, se i kom njoftë gjanat. Domethanë, kom pasë ni njohuri të përgjithshme, a din, edhe te Besim Dina jom konën, veç ni pyetje s'e kom ditë, një mijë euro ka qenë komplet për shembull fitimi, s'e kom, s'mu kujtojke Mozzarella [djathë] e kujna osht', e italianëve. 60 euro i kom hupë qaty me qatë pyetje, tjerat krejt i kom ditë, krejt i kom ditë, edhe si një ndër rekordmenët jom konë në atë kuizin e Besimit.

Anita Susuri: Zoti Bajram nëse keni edhe diçka me shtu?

Bajram Zymeri: Nuk di, ka, për momentin s'po më kujtohën se jeta osht' e gjatë, a din. Kështu osht' shtirë me u, kanihere tash edhe jonë bo do vjet u bo edhe memorja ka pak [ka fillu] me më lonën, po edhe pse mirë. Mirëpo, jom ni njeri i lumtun e kom ni familje të mirë.

Anita Susuri: Shumë mirë. Faleminderit shumë për intervistë!

Bajram Zymeri: Me nder qofshi. Faleminderit edhe juve!